



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORATI

**RAPORT VJETOR I VEPRIMTARISË NË UNIVERSITETIN
E ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**

PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023



A. SENATI AKADEMIK

a) **Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të UE-së.**

a. Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies.

a.1. Realizimi i objektivave krahasuar me planin strategjik.

a.2. Strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse.

b. Qëllimet dhe objektivat e kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit.

b.1. Realizimi i objektivave krahasuar me planin strategjik.

b.2. Strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse.

c. Të dhëna të përgjithshme në lidhje me raportet e vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies si dhe kërkimit shkencor.

i. Fusha Mësimdhënia

Qëllimi: (Të përcaktohet qëllimi i IAL-së në lidhje me këtë fushë të veprimtarisë së tij).

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (UE), veprimtarinë e vet për vitin akademik 2022-2023, e trajton sipas udhëzuesit “Për modelin e raportimit vjetor të institucioneve publike të arsimit të lartë në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 19.2.2018 të MASR (MAS) “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”.

Për vitin akademik 2022-2023, raportimi vjetor bazohet kryesisht në realizimin e misionit dhe detyrave të përcaktuara, arritjeve, vështirësive si dhe të objektivave e synimeve që ka për të ardhmen institucioni lidhur me veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare

Raportimi vjetor bazohet në analizat dhe vlerësimet për veprimtarinë e kryer nga organet drejtuese si Senati Akademik, Bordi i Administrimit si dhe nga të gjitha njësitë përbërëse pranë Rektoratit, analizat dhe vlerësimet për veprimtarinë e kryer prej njësisë bazë dhe njësisë kryesore të pesë fakulteteve si dhe raportin financiar të UE-së.

Veprimtaria e UE-së, është rezultat i bashkëpunimit të njësisë dhe strukturave drejtuese me personelin akademik dhe ndihmësakademik si dhe përshtatjes me drejtimit e përgjithshme të zhvillimit rajonal e më gjerë, zbatimit të politikave mbi arsimin e lartë sipas legjislacionit në fuqi, me vendimet e Qeverisë, udhëzimet dhe urdhrat nga MAS etj.

Nga analizat e kryera rezulton se në vijimësi drejtimit kryesore të punës në UE, janë:

- Programet e studimit të përshtaten me kërkesat e tregut;
- Pranimet e reja të jenë sa më cilësore dhe me kuota sa më reale;
- Veprimtaria e personelit të UE-së të kryhet sipas nevojave dhe udhëzimeve përkatëse;
- Realizimi në vijimësi i gjurmimit të studentëve që kanë përfunduar studimet;
- Rishikim i tarifave të shkollimit;
- Përmirësim i shërbimeve që UE ofron për studentët dhe të diplomuarit;
- Përmirësimi dhe paraqitja e detajuar e gjendjes financiare të institucionit.

Nga organet drejtuese të UE-së, realizohet raportimi nëpërmjet një materiali të përgatitur dhe të strukturuar sipas fushës së tyre të kompetencës.



Tabela nr. 1: Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies

Objektivi 1: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e mësimdhënies						
Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti/ Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1	Vijimi i akreditimit për programet e studimit.	Ngritja e grupeve të vlerësimit, trajnime nga ASCAL, hartimi i raporteve etj.	Fakultetet e UE, departamentet, NJSBC dhe drejtoritë	U akredituan 26 programe studimi. Vijon procedura për 35 programe të tjera.	Nëntor 2022 dhe vijim	Procedurat e akreditimit, plotësimi i rekomandimeve, janë në dinamikë e sipër, në ndjekje dhe zbatim nga strukturat përkatëse.
2	Rishikimi i planeve mësimore dhe kurrikulës në vijimësi.	Rishikimi i programeve të studimit për mësuesi, cikli i dytë, doktoraturës në shkencat mjekësore dhe humane, përshtatja e të gjitha programeve me udhëzimet përkatëse etj.	Fakultetet e UE, departamentet, drejtoria e kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë.	Janë kryer procedurat dhe janë miratuar në senatin akademik. Vijon aplikim për emërtimin e programeve të mësuesisë.	Realizuar deri në janar 2023	Ka patur mjaft diskutime deri në vendimmarrje.
3	Planifikimi dhe realizimi i ngarkesës mësimore.	Diskutim dhe miratim në departamente dhe fakultete.	Departamentet dhe DKSBC.	Respektimi i fushave dhe raporteve sipas kualifikimit, tituj dhe grada, personel efektiv dhe me kontratë etj.	Realizuar planifikimi deri në tetor 2022 dhe realizimi deri në shtator 2023.	Kujdes me titullarët e lëndëve duke u përmirësuar cilësia sipas titujve dhe gradave.
4	Përmirësimi në vijimësi i nivelit të mësimdhënies.	Rishikim i syllabuseve, literaturës, materialeve didaktike e laboratorike; analiza dhe diskutime etj.	Departamentet	Rishikim dhe përshtatje sipas udhëzimeve përkatëse	Vijimësi	Rishikim edhe me ndryshimet sipas udhëzimeve



Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti/ Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
5	Frekuentimi i leksioneve, seminareve, punëve laboratorike dhe praktikave.	Njohje me udhëzimet dhe rregulloret përkatëse, ndryshimet etj., sidomos për studentët e viteve të para.	Departamentet, Drejtoria juridike, Karriera dhe ALUMNI.	Takime, biseda dhe diskutime, propozime etj., në rektorat dhe strukturat e UE-së.	Vijimësi	Frekuentimi dhe rregullimi i orareve mësimore sidomos për ciklin e dytë.
6	Zhvillimi dhe mbarëvajtja e detyrimeve dhe provimeve.	Hartimi i strukturës mësimore, grafikut të shlyerjes së detyrimeve etj.	Fakultetet, DKSBBC, sektori i IT dhe sekretariatë mësimore.	Saktësimi i strukturës së vitit akademik sipas planeve mësimore dhe udhëzimeve. Funksionimi i sistemit ems dhe plotësimi i regjistrave përkatës.	Brenda muajit nëntor 2022, janar shkurt 2023 dhe qershor korrik 2023.	Kontroll në vijimësi i dokumentacionit.

ii. Fusha Kërkimi shkencor dhe veprimtaria krijuese dhe inovacioni

Qëllimi: (Të përcaktohet qëllimi i IAL-së në lidhje me këtë fushë të veprimtarisë së tij).

Krahas misionit të tij të parë, atë të edukimit, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, , përpiqet të realizojë më sukses edhe dy misionet e tjera: *kërkimin shkencor* dhe misionin e tretë tredimensional atë të *bashkëpunimit* me sektorin publik e privat të rajonit përmes transferës së teknologjisë së informacionit, angazhimit social dhe edukimit të vazhdueshëm.

Në UE reformimi dhe riorganizimi i kërkimit shkencor konceptohet dhe vlerësohet si faktor themelor për reformimin e veprimtarisë akademike, kërkimore e shkencore dhe njëherazi përcaktohet për vendosjen e standardeve evropiane. Universiteti i Elbasanit është gjithmonë aktiv në politikën e tij të jashtme, duke bashkëpunuar ngushtë me të gjitha universitetet shqiptare, por edhe me universitete të tjera të huaja përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalëshe me to, por gjithashtu edhe përmes bashkëpunimit në kuadër të projekteve të ndryshme.

Nga analizat e veprimtarisë së njësive bazë dhe kryesore rezultojnë se Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” organizon disa aktivitete të përvitshme shkencore kombëtare e ndërkombëtare me karakter periodik si dhe ka mjaft produkte të tjera në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve etj. Një pjesë e mirë e personelit akademik kanë studime,

kualifikime, specializime jashtë shtetit, falë kjo lidhjeve të shumta dhe mundësive që janë krijuar nga bashkëpunimet me universitetet e tjera homologë brenda dhe jashtë vendit.

Në mënyrë të përmbledhur, gjatë vitit akademik 2022-2023, në UE veprimtaritë janë:

- 11 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare,
- 7 takime dhe tryeza të rumbullakta ose tryeza diskutimi,
- 5 trajnime,
- 9 vizita institucionale, delegacione dhe nënshkrimi i marrëveshjeve,
- 3 ekspozita dhe promovime,
- 3 aktivitete Erasmus⁺,
- 9 aktivitete të Bordit Këshillimor të Biznesit,
- 15 aktivitete të tjera.

Personeli akademik e ka përqendruar në këto drejtime veprimtarinë e vet kërkimore-shkencore.

Tabela nr. 2: Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit

Objekti 1: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti/ Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1	Veprimtari kualifikuese si vijim i punës kërkimore-shkencore, fitimi i gradave dhe titujve shkencorë.	Planifikime sipas kërkesave ligjore, skeda e personelit akademik.	Departamentet	Respektimi i afateve kohore dhe cilësia e realizimit sipas kriterëve etj.	Sipas planifikimit për departamentin dhe personelin akademik	
2	Veprimtari botuese me publikime si artikuj, analiza shkencore, recensa shkencore për periodikë kombëtarë/ndërkombëtarë.	Planifikime sipas kërkesave ligjore, skeda e personelit akademik.	Departamentet, Drejtoria e koordinimit dhe marrëdhënieve me jashtë, buletini shkencor UNIEL etj.	Respektimi i afateve kohore dhe cilësia e realizimit sipas kriterëve etj.	Sipas planifikimit për departamentin dhe personelin akademik	
3	Referime dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, trajnime etj.	Planifikime sipas kërkesave ligjore, skeda e personelit akademik.	Departamentet, Drejtoria e koordinimit dhe marrëdhënieve me jashtë, buletini shkencor UNIEL etj.	Secili nga personeli akademik ka treguesit e vet.	Vijimësi	

Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Fakulteti/Drejtoria/Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
4	Pjesëmarrje në projekte	Aplikime dhe realizime, projekte të fituara	Fakultetet, Senati akademik, Bordi i Administrimit, Drejtoria ekonomike etj.	Fitimi i disa projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, bashkëpunime etj.	Realizime për periudha kohore 1 deri në 2 vite akademike.	
5	Udhëheqje e veprimtarisë kërkimore të studentëve, doktoratave, pjesëmarrje në komisione kualifikuese, juri etj.	Plotësim dhe respektim i kërkesave për udhëheqje, sipas fushave dhe tregut.	Fakultetet, departamente, këshillat e mbrojtjeve, qendrat kërkimore etj.	Realizuar sipas normave dhe planifikimeve.	Realizime për periudha kohore 1 deri në 3 vite akademike.	

b) Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte ku merr pjesë UE, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.

Universiteti i Elbasanit gjatë vitit akademik 2022-2023 falë koordinimit të mirë, ka arritur të rinovojë disa marrëveshje. Përmendim lidhjen e marrëveshjeve me universitetet partnere.

Objektivi kryesor i marrëveshjeve është bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve të palëve me synim komunikimin dhe shkëmbimin e personelit akademik, studentëve, informacioneve, ideve dhe eksperiencave që lidhen me fushat me interes të përbashkët.

Tabela nr. 3: Mbi bashkëpunimin ndërinstitucional

Institucioni bashkëpunues	bashkëpunimi (projekt/bashkëpunimi/tjetër)	Forma e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo projektit (marrëveshje ose Data e nënshkrimit të marrëveshjes	Fusha bashkëpunimit dhe produktet	Rezultatet/përfitimet në vlerë
Universita Degli Studi di Bari "Aldo Moro" Dipartimento di Economia e Finanza	Marrëveshje		Direzione Ricerca, Terza Missione e Internazionalizzazione.	
Universita Degli Studi di Bari "Aldo Moro"	Marrëveshje		Scientific research and education activities.	



Nr.	Institucioni bashkëpunues	Lloji i bashkëpunimit (projekt/bashkëpunim tjetër)	Forma e zyrarizimit të bashkëpunimit apo të projektit (marrëveshje)	Data e nënshkrimit të marrëveshjes	Fusha e bashkëpunimit
3	Universita Degli Studi di Bari "Aldo Moro" Academic Spin Off "Polypheno srl"	Marrëveshje			Research projects.
4	L' universita Degli Studi Dell' aquila	Marrëveshje			Formazione post-laurea e di ricerca (master o equivalente).
5	Travelbest	Marrëveshje			Implementation of curricular internships in Italy.
6	Zyrich University of Teacher Education	Marrëveshje			Teacher training institutions in Switzerland, Albania and Kosovo International cooperation in education.
7	UISP (Unione Italiana Sport per Tutti)	Marrëveshje			Sport.
8	Global Council for Tolerance and Peace, Malta	Marrëveshje			Organizing regional and international conferences in order to promote the culture of tolerance and peace.
9	International Institute for Culture Diplomacy	Marrëveshje			Cooperation in common research projects, study programs, training mobilities students and staff.
10	Valga County Vocational Training Centre	Marrëveshje			Cooperation in common research projects, study programs, training mobilities students and staff.
11	John Paul II Catholic University of Lublin	Marrëveshje			Cooperation in common research projects, study programs, training mobilities students and staff.
12	University of Oviedo	Marrëveshje			Research, study programs, training mobilities students and staff.
13	Mnedel University in Brno	Marrëveshje			Student exchange agreement.
14	Josip Juraj Strossmayer University of Osijek, Croatia	Marrëveshje			Fostering joint projects in the field of education and research.
15	Constatin Brancusi University of Targu-Jiu, Romania	Marrëveshje			Students and staff, joint research and educational projects.
16	Czech University of Life Sciences	Marrëveshje			Students and staff, joint research and educational projects.
17	University of National and World Economy	Marrëveshje			Students and staff, joint research and educational projects.



Nr.	Institucioni bashkëpunues	Lloji i bashkëpunimit (projekt/bashkëpunim tjetër)	Forma e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo projektit (marrëveshje ose të tjera)	Data e nënshkrimit të marrëveshjes	Fusha e bashkëpunimit
18	Northern Illinois University	Marrëveshje	Marrëveshje		Educational exchange.
19	International School Project	Marrëveshje	Marrëveshje		Cooperation in common research projects, study programmes, training mobilities students and staff.
20	St. Cyril and St. Methodius University of Veliko Tarnovo	Marrëveshje	Marrëveshje		Students and staff exchange.
21	Kolegji Biznesi, Prishtinë	Marrëveshje	Marrëveshje		Shkëmbimin e studentëve dhe stafit, projekte të edukimit dhe kërkimore.
22	Kolegji AAB, Prishtinë	Marrëveshje	Marrëveshje		Shkëmbimin e studentëve dhe stafit, projekte të edukimit dhe kërkimore.
23	Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"	Marrëveshje	Marrëveshje		Shkëmbim të stafit, promovimin e seminareve, kurseve, konferencave, përgatitjen e projekteve kërkimore.
24	Universiteti Euro-Balkan, Shkup	Marrëveshje	Marrëveshje		Bashkëpunim në fushën e kërkimit shkencor dhe mësimdhënies.
25	Universiteti "Kadri Zeka", Gjilan	Marrëveshje	Marrëveshje		Shkëmbim të stafit dhe të studentëve për kërkime shkencore, promovimin e seminareve, kurseve, konferencave, përgatitjen e projekteve kërkimore.
26	University of New York Tirana	Marrëveshje	Marrëveshje		The cooperation in common research projects. The cooperation in study programmes.
27	Universiteti Europian i Tiranës	Marrëveshje	Marrëveshje		Bashkëpunim dhe bashkërendimin e aktiviteve të palëve me synim komunikimin dhe shkëmbimin e personelit akademik, studentëve, informacioneve, ideve dhe eksperiencave që lidhen me fushat me interes të përbashkët.
28	Universiteti i Sporteve Tiranë	Marrëveshje	Marrëveshje		Komunikimin dhe shkëmbimin e personelit akademik, studentëve, informacioneve, ideve dhe eksperiencave që lidhen me fushat me interes të përbashkët.



Nr.	Institucioni bashkëpunues	Lloji i bashkëpunimit (projekt/bashkëpunim tjetër)	Forma e zyrtarizimit të bashkëpunimit (marrëveshje ose projekt tjetër)	Data e nënshkrimit të marrëveshjes	Fusha e bashkëpunimit
29	Universiteti i Mjekësisë Tiranë	Marrëveshje			Shkëmbimin e personelit akademik për procesin mësimor, shkëmbimin e pedagogëve, të kërkuesve dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarisë kërkimore shkencore. Shkëmbimin e përvojës lidhur me menaxhimin instiucional.
30	Albanian University	Marrëveshje			Zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme në drejtimin e studimeve shkencore. Promoviminin e iniciativave shkencore dhe shkëmbimin kulturor.
31	Akademia e Studimeve Albanologjike	Marrëveshje			Institucionalizimi i marrëdhënieve për bashkëpunim dhe bashkërendimin e aktiveve të palëve me synim komunikimin, shkëmbimin e personelit akademik, studentëve, informacioneve, ideve dhe eksperiencave me interes të përbashkët.
32	Universiteti i Tiranës	Marrëveshje			Shkëmbimin e personelit akademik për procesin mësimor, shkëmbimin e pedagogëve, të kërkuesve dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarisë kërkimore shkencore, nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore. Shkëmbimin e përvojës lidhur me menaxhimin instiucional.
33	Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	Marrëveshje			Promoviminin e arsimit të lartë, kërkimin shkencor, rritjen dhe kapacitetin e personelit akademik dhe të studentëve.
34	Albanian University	Marrëveshje			Promoviminin e arsimit të lartë, kërkimin shkencor, rritjen kapacitetin e personelit akademik dhe të studentëve.
35	Universiteti "Fan.S.Noli" Korçë	Marrëveshje			Promoviminin e arsimit të lartë, kërkimin shkencor, rritjen kapacitetin e personelit akademik dhe të studentëve.
36	British Council	Marrëveshje			Përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe tretë në institucionet e arsimit të lartë.
37	Administrata rajonale e zonave të mbrojtura, Elbasan	Marrëveshje			Zhvillimin e nismave dhe aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të këshillimit të karrierës dhe ofrimit të shërbimeve mbështetëse.



Nr.	Institucioni bashkëpunues	Lloji i bashkëpunimit (projekt/bashkëpunim tjetër) Forma e zyrtarizimit të bashkëpunimit (rapo të projektit bashkëpunues tjetër)	Data e nënshkrimit të bashkëpunimit	Fusha e bashkëpunimit
38	Qendra Spitalore "Xhaferr Kongoli", Elbasan	Marrëveshje		Realizimi i praktikës profesionale dhe aktiviteti shkencor-kërkimor pranë Spitalit Rajonal Elbasan.
39	Spitali psiatrik "Dr. "Sadik Dinçi", Elbasan	Marrëveshje		Realizimin e praktikave profesionale të studentëve të Fakultetit të Shkencave mjekësore teknike me specialistë të ndryshëm në bashkëpunimin me strukturat mësimdhënëse.
40	Bashkia Elbasan	Marrëveshje		Zhvillimin e praktikave profesionale në institucione.
41	Këshilli i Qarkut, Elbasan	Marrëveshje		Zhvillimin e praktikave profesionale në institucione.
42	Drejtoria rajonale e shëndetit, Elbasan	Marrëveshje		Zhvillimin e praktikave profesionale në institucione.
43	Prefekti i Qarkut, Elbasan	Marrëveshje		Zhvillimin e praktikave profesionale në institucione.
44	Zyra e shërbimit të provës, Elbasan	Marrëveshje		Zhvillimin e praktikave profesionale në institucione.
45	Bashkia Cerrik	Marrëveshje		Zhvillimin e praktikave profesionale në institucione.
46	Zyra vendore arsimore, Elbasan	Marrëveshje		Marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave mësimore.
47	Autoriteti i konkurrencës	Marrëveshje		Zhvillimin e nismave dhe aktiviteteve të përbashkëta.
48	European movement, Albania	Marrëveshje		Zhvillimin e praktikave, nismave të përbashkëta në kuadër të procesit të integritetit evropian.
49	Drejtoria rajonale e arsimit, Korçë	Marrëveshje		Për zhvillimin e praktikave profesionale në institucione.
50	Qendra e Testimit S.T.A	Marrëveshje		Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja, testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë.
51	University Of Cambridge	Marrëveshje		Sigurimin e standardit gjatë procesit të testimit të gjuhës angleze, garantimin e certifikimit të rezultatit të arritur gjatë testimit



	Institucioni bashkëpunues	Lloji i bashkëpunimit (projekt/bashkëpunim tjetër)	Forma e zyrtarizimit (marrëveshje ose të tjera)	Data e nënshkrimit të marrëveshjes	Fusha e bashkëpunimit
52	Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Elbasan	Marrëveshje			Për zhvillimin e praktikave mësimore
53	Albanian-American Development Foundation	Marrëveshje			Zbatimin e projektit CleanScore në përcaktimin e cilësisë së materialeve mësimore dhe vlerësimin e performancës së studentëve.
54	Drejtoria e përgjithshme e arkivave	Marrëveshje			Promovimin e arsimit të lartë, kërkimin shkencor, rritjen e kapaciteteve të personelit akademik dhe të studentëve.
55	Qendra "Gratë në Shërbim Publik"	Marrëveshje			Shkëmbimin e informacionit reciprok, angazhimin ndërmjet palëve për nxitjen e mundësive të reja veçanërisht të studentet vajza.
56	Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së parë, Elbasan	Marrëveshje			Për zhvillimin e praktikave mësimore.
57	Save The Children	Marrëveshje			Promovimin e arsimit të lartë, kërkimin shkencor rritjen e personelit akademik dhe të studentëve.
58	Elite Travel Group	Marrëveshje			Zhvillimin e nismave të aktiviteteve të përbashkëta.
59	Drejtoria rajonale e kulturës kombëtare, Durrës	Marrëveshje			Bashkëpunimin dhe mbështetjen e studentëve në zhvillimin e praktikave mësimore në mjediset e këtij institucioni.
60	Albanian Center For Quality Journalism	Marrëveshje			Lehtësimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale për bashkëpunim e bashkërendimin e aktiviteteve të palëve me synim komunikimin dhe shkëmbimin e ideve, informacionit dhe eksperiencave.
61	Save The Children	Marrëveshje			Sfidat aktuale të studentëve lidhur me praktikat profesionale me fokus edukimin e femijëve nga pakicat etnike.
62	Komisioni për mbrojtjen nga diskriminimi	Marrëveshje			Promovimin e arsimit të lartë, kërkimin shkencor rritjen e kapacitetit të personelit akademik dhe studentëve.
63	Qendra Balashe Bashkia, Elbasan	Marrëveshje			Kryerja e praktikave profesionale dhe aktivitetin kërkimor-shkencor pranë qendrës Balashe, Bashkia Elbasan.



Nr.	Institucioni bashkëpunues	Lloji i bashkëpunimit (projekt/bashkëpunim tjetër)	Forma e zyrtarizimit të bashkëpunimit (marrëveshje ose të tjera)	Data e nënshkrimit të marrëveshjes	Fusha e bashkëpunimit
64	Internacional Virtual E-Hospital Foundation	Marrëveshje			Ndërtimi dhe vendosja në funksionim e qendrës së teleinfieristikës, ekselencës dhe njësisë së trajtimit të urgjencës mjekësore.
65	Protik Innovatin Center	Marrëveshje			Zhvillimin e sektorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
66	Kuvendi i Shqipërisë	Marrëveshje			Institucionalizimi i marrëdhënieve për bashkëpunim dhe bashkërendimin e aktiviteteve të palëve me synim komunikimin dhe shkëmbimin e informacioneve etj.
67	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Marrëveshje			Zhvillimin dhe transmetimin e dijeve përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve nga instucionet e IAL. Iartë
68	Kryqi i Kuq Shqiptar	Marrëveshje			Realizimin e projektit të dhurimit vullnetar të gjakut.
69	Itali, Politecnica delle Marche University, Ancona	Marrëveshje	në kuadër të	Mobiliteteve Erasmus+	
70	Itali, Bologna University	Marrëveshje	në kuadër të	Mobiliteteve Erasmus+	
71	Itali, University of L'Aquila	Marrëveshje	në kuadër të	Mobiliteteve Erasmus+	
72	Itali, University of Foggia	Marrëveshje	në kuadër të	Mobiliteteve Erasmus+	
73	Itali, University of Palermo	Marrëveshje	në kuadër të	Mobiliteteve Erasmus+	
74	Itali, University of Firenze	Marrëveshje	në kuadër të	Mobiliteteve Erasmus+	
75	Poloni, Catholic University of Lublin	Marrëveshje	në kuadër të	Mobiliteteve Erasmus+	
76	Poloni, Cracow University of Economics	Marrëveshje	në kuadër të	Mobiliteteve Erasmus+	
77	Poloni, Nicolaus Copernicus University	Marrëveshje	në kuadër të	Mobiliteteve Erasmus+	
78	Poloni, The University of Dabrowa Gronicza WSB	Marrëveshje	në kuadër të	Mobiliteteve Erasmus+	



Nr.	Institucioni bashkëpunues	Lloji i bashkëpunimit (projekt/bashkëpunim tjetër)	Forma e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit (marrëveshje ose tjetër)	Data e nënshkrimit të marrëveshjes	Fusha e bashkëpunimit
79	Poloni, Wrocław University of Science and Technology	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit (marrëveshje ose tjetër)	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
80	Bullgari, New Bulgarian University	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
81	Bullgari, University of National and World Economy	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
82	Bullgari, South West University "Neofit Rilski"	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
83	Bullgari, University of Economics Varna	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
84	Bullgari, Sofia University st.Kliment Ohridski	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
85	Bullgari, Tsenov Academy of Economics	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
86	Rumani, Alexandru Ioan Cuza University (IASI)	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
87	Rumani, Politechnica University of Timisoara	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
88	Rumani, University of Pitesti	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
89	Rumani, Andrei Saguna	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
90	Spanjë, Universidad de Jaen	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
91	Spanjë, Complutense University of Madrid	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
92	Spanjë, University of A Corruña	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
93	Spanjë, Universidad of Cordoba	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
94	Spanjë, Institut Joan Brossa	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
95	Spanjë, Institut Provençana	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit
96	Spanjë, Cipfj Valle de Elda	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit	Marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit



Nf.	Institucioni bashkëpunues	Lloji i bashkëpunimit (projekt/bashkëpunim tjetër) Formë e zyrtarizimit apo bashkëpunimit (marrëveshje ose tjetër)	Data e nënshkrimit të marrëveshjes	Fusha e bashkëpunimit
97	Spanjë, Centro Integrado de Formacion Profesional Sectores Industrial y Servicios la Laboral	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
98	Spanjë, IES Ricardo Mella	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
99	Spanjë, IES Ribiera do Luoro	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
100	Spanjë, CEBEM Formacion Profesional	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
101	Spanjë, CIPFP Luisd Saner Sanchis Spain	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
102	Spanjë, CEEDCV Centro Especifico de Educacion a Distancia de la Comunidad Valenciana	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
103	Spanjë, IES Luis Seoane	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
104	Mendel University Brno, Czech Republic	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
105	Turqi, Istanbul Sehir University	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
106	Turqi, Kirlareli University	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
107	Turqi, Istanbul Technical University	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
108	Turqi, Bolu University Abant Izzet	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
109	Turqi, Staffordshire University	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
110	Gjermani, Ludwigshafen University	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
111	Greqi, Aristotele University	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
112	Portugali, ISCTE – Instituto Universitario de Lisboa	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+



Nr.	Institucioni bashkëpunues	Lloji i bashkëpunimit (projekt/bashkëpunim tjetër)	Forma e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit (marrëveshje ose të tjera)	Data e nënshkrimit të marrëveshjes	Fusha e bashkëpunimit
113	Francë, University of Nice	Marrëveshje në kuadër të	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
114	Lituanë, Klaipeda University	Marrëveshje në kuadër të	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
115	Finlandë, Abo Academy	Marrëveshje në kuadër të	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+
116	Austri, College of Teacher Education Carinthia	Marrëveshje në kuadër të	Marrëveshje në kuadër të	Mobiliteve Erasmus+	Erasmus+



Veprimtari të tjera bashkëpunimi:

• TRAJNIME

1. **11.10.2022.** Në Universitetin e Elbasanit u organizua takimi trajnues nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, me grupet e punës, personelin akademik dhe drejtoritë përkatëse të UE-së.
2. **25-26.10.2022.** Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u zhvillua trajnimi dyditor për studentët "Fuqizimi i të rinjve pas pandemisë: Sfidat dhe mundësitë".
3. **17.11.2022.** Në kuadër të projektit "Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen e jetës private dhe familjare në Shqipëri", u organizua në Universitetin e Elbasanit trajnimi me student të programit të studimit në Drejtësi në Fakultetin Ekonomik.
4. **14.12.2022.** Në kuadër të projektit "Ne jemi kampionë", Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, si dhe Organizatën Special Olympics Albania, zhvilluan workshopin me temë "Sporti gjithëpërfshirës".
5. **20.12.2022.** Organizohet në Fakultetin Ekonomik programi "Klubi i Debatit". Ky program realizohet në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes Universitetit të Elbasanit dhe Junior Achievement Albania, i financuar nga Fondi Amerikan i Zhvillimit.
6. **30.05.2023.** Në ambientet e Universitetit të Elbasanit, u zhvillua një trajnim nga Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri, me studentë nga programe të ndryshme studimi. Qëllimi i këtij trajnimi ishte përgatitja e të rinjve për t'u përfshirë suksesshëm në tregun e punës.
7. **19-21.06.2023.** Në kuadër të projektit EntrAL financuar nga EU, u organizua sesioni i parë i trajnimeve pilot, për studentët e të gjitha programeve të studimit në UE, në lidhje me Edukimin mbi Sipërmarrjen, me temë "Kampi për inovacionin në sipërmarrje, për studentët".
8. **22-23.06.2023.** Në kuadër të projektit EntrAL financuar nga EU, u organizua sesioni i parë i trajnimeve pilot, për stafin akademik të të gjitha fakulteteve të UE së, në lidhje me edukimin mbi sipërmarrjen "Drejt një mendësie sipërmarrëse".
9. **3-4.07.2023.** a-STEP Cost Action organizoi të parin trajnim (Training School) në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", në datat 3-4 korrik 2023 ku bëri bashkë rreth 30 pjesëmarrës nga 8 shtete, si: Shqipëria, Irlanda, Austria, Portugalia, Karolina e Veriut, Shtetet e Bashkuara, Turqia, Bullgaria.

• VIZITA INSTITUCIONALE, DELEGACIONE DHE NËNSHKRIM MARRËVESHJE

1. **26.10.2022.** Rektori zhvilloi një takim zyrtar të frytshëm me rektorin e Universitetit të Janinës z. Triantafyllos A.D. Albanis.



2. **3.12.2022.** Fakulteti i Shkencave të Edukimit, në kuadër të 16 ditëve të sensibilizimit kundër dhunës me bazë gjinore, mirëpriti si të ftuar nderi shkrintaren Helena Kadare.
3. **8.02.2023.** Prof. dr. Skender Topi, mirëpriti në një takim të frytshëm në kuadër të ndërkombëtarizimit, Ambasadorin Britanik në Shqipëri, z. Alastair King-Smith.
4. **20.03.2023.** Zëvendësrektorja e Universitetit të Elbasanit, Prof. assoc. dr. Elvira Fetahu, mirëpriti në një takim zyrtar Ambasadoren e Suedisë në Shqipëri, znj. Elsa Håstad, ku u diskutua mbi bashkëpunimet e deritanishme dhe urat e bashkëpunimit në të ardhmen me institucionet e arsimit të lartë në Suedi, si edhe me institucionet e tjera partnere.
5. **3.04.2023.** Nënshkruhet Memorandum Bashkëpunimi midis Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Qëllimi i këtij memorandumi është bashkëpunimi në thellimin dhe shkëmbimin e njohurive në fushën e drejtësisë, duke ndërmarrë veprimtari me interes të përbashkët.
6. **6.04.2023.** Rektori i Universitetit të Elbasanit, mori pjesë në Senatin e Republikës në Itali, ku u mbajt Konferenca e Parë Ndërkombëtare për Fondet Evropiane, me pjesëmarrës aktorë shkencorë nga Amerika e Veriut dhe aktorë shkencorë nga Zona Euromesdhetare. Në këtë takim të rëndësishëm u nënshkrua marrëveshja strategjike e bashkëpunimit me Presidentin e Qendrës Ndërkombëtare të Studimeve Ekonomike për Fondet e BE-së UE, Prof. Santi Tomaselli, me Prof. Michele Vincenti i Universitetit Perëndimor të Kanadasë, si dhe Përfaqësuesin e Punëve të Jashtme dhe Biznesit të Egjiptit Prof. Basem Ibrahim.
7. **9.06.2023.** Në vijim të aktiviteteve në kuadër të 100-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike Shqipëri-Turqi, Ambasadori turk në Shqipëri, z. Tayyar Kağan Atay, vizitoi Universitetin e Elbasanit, ku u takua me rektorin Prof. dr. Skender Topi, si dhe zhvilloi një bashkëbisedim me studentë e pedagogë të universitetit.
8. **28-29.09.2023.** Rektori i Universitetit të Elbasanit, Prof. dr. Skender Topi, i shoqëruar nga personeli akademik i universitetit, mori pjesë për dy ditë në një sesion studimor organizuar nga Universiteti Papnor Gregorian, Itali me temë: “Debati ndërfetar: Kontributi i Shqipërisë në Ballkan”. Sesioni studimor dhe kërkimor do të zhvillohet rreth temës së kontributit të Shqipërisë, nëpërmjet komuniteteve të saj të ndryshme fetare, në dialogun ndërfetar në Mesdhe dhe Ballkan.

• EKSPOZITA DHE PROMOVIME

1. **12.01.2023.** Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, u zhvillua ceremonia e dhurimit të pajisjeve teknologjike mësimore nga Ambasada e Kinës në Shqipëri, për Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
2. **3.02.2023.** Universiteti i Elbasanit, në kuadër të premierës “Profesionisti”, mirëpriti si të ftuar të veçantë regjisorin Leka Bungo, aktorët Viktor Zhusti dhe Astrit Hasani.



3. **13.03.2023.** Departamenti i Gjuhësisë dhe Qendra e Studimeve Albanologjike e Ballkanologjike organizuan promovimin e monografisë "Gjurmë të apofonisë indoevropiane në gjuhën shqipe" të Prof. Albert Riska.
4. **14.04.2023.** Në kuadrin e veprimtarive të Fakultetit të Shkencave Humane dhe me mbështetjen e Rektoratit të UE-së, Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhësisë, organizuan në mjediset e Bibliotekës së UE-së, promovimin e librit "William Shakespeare" të Victor Hugo, përkthyer nga Abdulla Rami dhe Ermira Xhomaqi - Godo.
5. **24.05.2023.** Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u promovua libri i "Giovanni Falcone. Një hero i vetmuar", me prezencën e shqipëruetit Magj. Engert Pëllumbi.

- **AKTIVITETE ERASMUS+**

1. **1-4.11.2022.** Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin e Elbasanit, organizoi 4 ditë radhazi në fakultetet e universitetit, ditët informuese në kuadër të mobiliteteve Erasmus+.
2. **17-21.04.2023.** Përfaqësues nga Universiteti i Elbasanit, morën pjesë në Javën Ndërkombëtare të Erasmus+, të organizuar nga Universiteti i Ekonomikut, Krakov, Poloni.
3. **8-12.05.2023.** Universiteti i Elbasanit, në kuadër të Programit Erasmus+, organizoi Javën e 2-të Ndërkombëtare "Kultura dhe Komunikimi", ku u zhvilluan një sërë aktiviteteve me pjesëmarrës nga universitetet partnere të cilët mundën të njihnin nga afër universitetin dhe qytetin e Elbasanit, të shkëmbenin njohuri dhe përvoja, si dhe të ndanin praktikën më të mirë.
4. **25.09.2023.** Universiteti i Elbasanit, organizon për të dytin vit radhazi takim "Erasmus+ Mobility Caffè", në kuadër të takimeve pas mobilitetit për studentët e universitetit. Studentët mundën të ndajnë eksperiencat e tyre dhe rëndësinë e mobiliteteve në zhvillimin e tyre social, intelektual dhe akademik.

- **AKTIVITETE TË BORDIT KËSHILLIMOR TË BIZNESIT**

1. **4.04.2023.** Në kuadër të Bordit Këshillimor, u zhvillua një takim me përfaqësues të Elite Travel Group dhe studentëve nga programe të ndryshme studimi. Ky takim kishte për qëllim informimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit, për rëndësinë dhe potencialin e turizmit në vendin tonë, si dhe mundësitë që ofron ky sektor për krijimin e vendeve të reja të punës.

- **TAKIME INFORMUESE/NDËRGJEGJËSUESE**



1. **20.10.2022.** Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u prezantua programi ndërkombëtar i bursave Chevening ofruar nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.
2. **31.10.2022.** Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u prezantuan raportet e para shkencore të projekteve fituese të Programit Kombëtar të Kërkimit dhe Zhvillimit.
3. **16.11.2022.** Fondi Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit (AADF), organizoi në Universitetin e Elbasanit, një sesion informues me pedagogë dhe studentë mbi programet në fushën e edukimit, aplikimet e programit MIP Internship, procedurat e aplikimit në programin "READ", si dhe risitë e projektit "CleanScore", për këtë vit akademik.
4. **18.11.2022.** Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, prezantoi në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Elbasanit, studimin e përgatitur mbi demokracinë e brendshme në partitë politike shqiptare.
5. **7.12.2022.** Në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore, u zhvillua në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike një takim ndërgjegjësues.
6. **15.12.2022.** Në kuadër të bashkëpunimit të Departamentit të Letërsisë e Gazetarisë me Institutin Shqiptar të Medias, si pjesë e projektit "Rritja e nivelit të literacisë së medias të studentët dhe publiku i gjerë përmes produkteve videografike interaktive", u prezantua për studentët dokumentari televiziv "Të vërtetat e mediave".
7. **16.12.2022.** Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim, zhvilloi sesionin informues me studentë të programit të studimit të drejtësisë, ekonomisë dhe gazetarisë, mbi parandalimin e pastrimit të parave.
8. **9.01.2023** Në Universitetin e Elbasanit u organizua një takim me Shkollën e Magjistraturës, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për rolin dhe pozicionin e magjistratit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor.
9. **20.01.2023.** Rektori i Universitetit të Elbasanit Prof. dr. Skender Topi, zhvilloi një takim me doktorantët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, ku pjesëmarrësit në këtë takim, ndanë me doktorantët rekomandime, udhëzime dhe këshilla të vlefshme në kërkimin e tyre shkencor.
10. **25.01.2023.** Universiteti i Elbasanit, mirëpriti maturantë nga Shkolla e Mesme e Gjuhëve të Huaja, me qëllim njohjen dhe informimin mbi mundësitë, hapësirat dhe shërbimet e ofruara për studentët. Pjesë e këtij takimi ishin përfaqësues nga Fakulteti i Shkencave Humane, zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, si dhe nga zyra e Marrëdhënieve me Jashtë.
11. **26.01.2023.** Në Universitetin e Elbasanit, studentë nga Fakulteti i Shkencave Humane, zhvilluan një takim frytdhënës me gazetarin Mentor Kika, ku ndau me



studentët përvojat personale në fushën e gazetarisë, përshkrim të situatës aktuale të gazetarisë në vend, sfidat, detyrat dhe përgjegjësitë e një gazetari.

12. **6.02.2023.** Në Universitetin e Elbasanit, u prezantua për studentët, projekti SPINAHER-heritage, Art and Business Intensive Programme, nga drejtuesja e projektit znj. Justyna Dabrowska.
13. **2,6,9,16,28-28.03.2023.** Në kuadër të "Ditëve të informimit", Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe Alumni me mbështetjen edhe të Zyrës Vendore Arsimore Elbasan, zhvilloi në ambientet e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", një cikël takimesh me shkollat e mesme publike dhe jopublike të Bashkisë Elbasan.
14. **20.03.2023.** Personeli akademik, ndihmësakademik dhe administrativ i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", mirëpriti në Panairin Work&Study 2023, zhvilluar në Pallatin e Sportit, maturan të të shumtë të cilët u informuan mbi programet e studimit dhe mundësitë e shumta që ofrohen nga universiteti.
15. **29.09.2023.** Në Universitetin e Elbasanit u zhvillua një takim informues me nxënës nga shkolla profesionale "Faik Konica" Ferizaj, Kosovë, në bashkëpunim me Shkollën e Mesme Profesionale, Elbasan, mbi paketën akademike, infrastrukturën, mbështetjen e stafit akademik dhe ndihmësakademik, si edhe mundësitë e shumta, për zgjedhjen e rrugëtimit të tyre akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

• LEKSIONE TË HAPURA, SEMINARE, FORUME, SIMPOZIUME

1. **10.01.2023.** Universiteti i Elbasanit, mirëpriti në ambientet e tij gazetarin e mirënjohur Ksenofon Ilia, ku njohu më nga afër studentët e Fakultetit të Shkencave Humane me termin "Stenografi", rëndësinë, rolin dhe dobinë e përdorimit të tij në fusha të ndryshme.
2. **15.02.2023.** Universiteti i Elbasanit, mirëpriti nxënës nga gjimnazi "Dhaskal Todri", për të zhvilluar një orë mësimi të hapur në kuadër të lëndës së Këshillimit të Karrierës.
3. **24.02.2023** Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, organizuan për studentët një forum mbi zhdukjen e njerëzve gjatë regjimit komunist në Shqipëri.
4. **6.04.2023** Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" u zhvillua një leksion i hapur nga zëvendësministria e Ministrisë së Drejtësisë dhe zëvendëskryenegociatorja znj. Adea Pirdeni, ku prezantoi studentët rreth ecurisë së negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian – Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore", rëndësinë e këtij procesi për qytetarët në tërësi, juristët, studentë të historisë dhe gazetarisë.



5. **26.04.2023.** Në kuadër të marrëveshjes me Universitetin e "Tampere University of Applied Science" Finlandë, Departamenti i Infermieristikës në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, zhvilloi leksionin e hapur me temë "Genomics, The future of Nursing" si fjala e fundit dhe sfida aktuale e infermieristikës.
6. **27.04.2023.** Në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike është zhvilluar Simpoziumi Shkencor "Ndikimi i COVID-19 në organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor, implementimi i një modeli epidemiologjik matematikor".

• **AKTIVITETE TË TJERA**

1. **21.12.2022.** Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar Dega Elbasan dhe Bankën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, organizuan një sesion dhurimi vullnetar të gjakut në ambientet e universitetit.
2. **1.04.2023.** Në Universitetin e Elbasanit, nën mbikqyrjen e Departamentit të Matematikës, u zhvillua Olimpiada e Kangurit të matematikës.
3. **20.09.2023.** Në bibliotekën e Universitetit të Elbasanit, u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së certifikatave për studentët që zhvilluan praktikën profesionale në drejtoritë e universitetit, ku mundën të njihnin nga afër se si zhvillohen procedurat administrative në brendësi të një institucioni publik.

c) Informacion mbi kërkimin shkencor në UE ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:

i) Politikat e kërkimit shkencor.

- a. Prioritetet në lidhje me kërkimin shkencor.
- b. Objektivat dhe synimet bazuar në strategjinë kombëtare dhe ndërkombëtare për kërkimin shkencor
- c. Të dhëna mbi projektet e kërkimit shkencor, në të cilat universiteti ka aplikuar sipas tabelës.

Kërkimi shkencor është një nga misionet kryesore të UE-së. Sipas natyrës dhe objektivave specifike të institucionit, njësitë kryesore dhe bazë që janë pjesë përbërëse të UE-së, kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore bazë, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese. Për Universitetin e Elbasanit prioritet është përfshirja në programet evropiane dhe bashkëpunimi në programe studimesh të përbashkëta me universitete partnere etj.

Një nga elementët e rëndësishëm të kërkimit shkencor lidhet me shkrimin dhe aplikimin në projekte për ngritjen e kapaciteteve.

Gjatë vitit akademik 2022-2023 është punuar për të marrë pjesë në projekte të kërkimit shkencor kombëtare dhe ndërkombëtare. Projektet kombëtare janë financuar nga AKKSHI ku janë



aplikuar 15 projekte dhe janë financuar 8 prej tyre. Projektet kombëtare infrastrukture janë financuar nga AKKSHI ku janë aplikuar 3 projekte dhe janë financuar 2 prej tyre. Projekte të kërkimit shkencor të financuara nga Universiteti i Elbasanit ku janë aplikuar 8 projekte dhe janë financuar 8 projekte. Të dhëna të detajuara mbi projektet gjenden në vijim. U aplikuan 19 projekte për ngritjen e kapaciteteve ose projekteve të tjera ndërkombëtare dhe u fituan 3 projekte.

Tabela nr. 4. Mbi projektet e kërkimit shkencor në të cilat IAL ka aplikuar për financim

Projekte të aplikuara për financim				
Nr.	Emër, mbiemër (Koordinator)	Fakulteti	Titulli i projektit	Institucioni financues/bashkëpunues
1.	Prof. as. dr Elvira Fetahu	FE	“Hartëzimi i zonave të ndotura (hot spots) në qytetin e Elbasanit dhe identifikimi i metodave të rikuperimit të gjelbërt (green recovery)” Fituar	AKKSHI
2.	Dr. Eliona Gremi	FE	“Kritika e ndërgjegjësimit të edukimit financiar tek të rinjtë në Qarkun e Elbasanit.” Fituar	AKKSHI
3.	Dr. Teuta Hazizi	FE	“Korniza Evropiane e sipërmarrjes në qendër të përgatitjes të studentëve si sipërmarrës dhe fuqi punëtore e së ardhmes”	AKKSHI
4.	Dr. Kladiola Gjini	FE	“Ulja e varfërisë nëpërmjet fuqizimit të grave në zonat rurale të Elbasanit, duke diversifikuar burimet e të ardhurave të tyre”	AKKSHI
5.	Prof. as. dr. Teuta Toska	FSHH	“Dokumentimi, regjistrimi dhe ruajtja e pasurisë gjuhësore dhe etnokulturore të pakicës rome në rajonin e Elbasanit”	AKKSHI
6.	Dr. Mirela Shella	FSHH	“Letërsia për fëmijë dhe të rinj dhe Identiteti kombëtar”	AKKSHI
7.	Dr. Resul Telhaj	FSHH	“Hulumtime mbi Funkcionin dhe Karakteristikat Gjuhësore të Diskursit të nxënësve të Arsimit të Mesëm të Lartë (Probleme në përdorimin e tipave kumtuesorë të fjalive)”	AKKSHI
- Në studime e projektme për vitin 2022 janë parashikuar 4 objekt me vlerë 14,384 mijë lekë. Për periudhën e analizuar është realizuar procedura e prokurimit lidhja e kontratës dhe likuidimi i faturave për 3 projekte me vlerë 13,136 mijë lekë, ose 80.18% e fondit të planifikuar, sipas objekteve në “Tabela 2 - Investime viti 2022 - të ardhurat e institucionit”;
- ✓ Projekt + preventiv "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT" në vlerën 11,640 mijë lekë, ose 97.00 % e vlerës së planifikuar. Sipas preventivit të realizuar nga preventivuesi objekti "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT" parashikohet të ndërtohet në vlerën 925,833,442 lekë;
- ✓ Projekt + preventiv "Rikonstruksion salla e konferencave 111 - FSHE" në vlerën 498 mijë lekë, ose 99.60 % e vlerës së planifikuar. Sipas preventivit të realizuar nga preventivuesi objekti " Rikonstruksion salla e konferencave 111 - FSHE" parashikohet të ndërtohet në vlerën 19,793,177 lekë;
- ✓ Projekt + preventiv "Sistem WiFi në godinat e UE" në vlerën 998 mijë lekë, ose 99.84 % e vlerës së planifikuar. Sipas preventivit të realizuar nga preventivuesi objekti " Sistem WiFi në godinat e UE" parashikohet të ndërtohet në vlerën 17,500,000 lekë;
- Në patenta, liçenca, soffte kompjuterike për vitin 2022 është parashikuar fondi me vlerë 2,000 mijë lekë për pajisjet e parashikuara në laboratorë. Ky fond nuk është realizuar, pasi dhe objekti i investimit “Pajisje profesionale (laboratorike) nuk është realizuar.

- **Investimet - Artikulli 231: Ndërtme të reja, rikonstruksion objekte ndërtimore, pajisje të ndryshme**

Në këtë grup përfshihen shpenzimet për investime për: ndërtme e rikonstruksione objekteve, blerje pajisje për auditorët e zyrat, blerje pajisje laboratorike për laboratorët mësimorë e shkencorë, krijim i fondit të librit në bibliotekë etje.

Projektet e investimeve të financuara paraqiten në tabelën “Tabela 2 - Investime viti 2022 - të ardhurat e institucionit” dhe janë realizuar në vlerën 28,041 mijë lekë, ose 7.68 % e planit të buxhetit vjetor ose 10.16% e planit të çelur për përdorim në degën e Thesarit.



Treguesit e realizimit të investimeve janë në nivele të ulëta pasi në investimet e planifikuara vetëm, projekti “Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT” zë 64.⁸⁹ % të investimeve, për të cilin janë kryer disa procese paraprake dhe është aplikuar për nxjerrjen e lejes së ndërtimit. Investimet e projekteve të planifikuara për vitin 2022 janë realizuar:

- Ndërtimet e reja janë realizuar në vlerën 9,048 mijë lekë, ose 3.¹⁷ % e fondeve të planifikuara;
 - ✓ Projekti "Kolaudim - Ndërtim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT" është realizuar për vlerën 2 mijë lekë, i cili është realizuar në vitin 2021, por subjekti “DEA-N CONSULTING STUDIO” ka prerë faturën 1/2022 datë 21.04.2022 me vlerë 1,920 lekë e cila është likuiduar në maj 2022;
 - ✓ Projekti " Ndërtim - "Shkallë emergjence godinat e UE" është realizuar për vlerën 7,075 mijë lekë, i cili ka filluar punimet lidhjen e kontratës 16.08.2021 me subjektin “NIKA” shpk ka prerë faturën 1/2022 datë 21.04.2022. ky projekt ka përfunduar më 20.12.2022, është marrë në dorëzim. Subjekti është likuiduar për 95% të kontratës, ndërsa garancia e punimeve në masën 5% është depozituar në Degën e Thesarit, sipas procedurave ndërtimore.
 - ✓ Projekti “Efiçenca e energjisë në godina –‘Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike – FSHMT”” është realizuar për vlerën 1,796 mijë lekë, ose 99.⁷⁸% e fondeve të planifikuara.

Nr.	Emërtimi i projektit	Fondi 000/ lekë		
		Plani	Fakti	%
I	Studime e projekttime, patenta, liçenca, soffte kompjuterike	16,384	13,136	80.18
a	Studime e projekttime	14,384	13,136	91.32
1	Projekt + preventiv "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane " - ish materniteti" - ndryshim projekti	884	0	0.00
2	Projekt + preventiv "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT"	12,000	11,640	97.00
3	Projekt + preventiv "Rikonstruksion salla e konferencave 111 - FSHE"	500	498	99.60
4	Projekt preventiv "Sistem WiFi në godinat e UE"	1,000	998	99.84
b	Patenta, liçenca, soffte kompjuterike	2,000	0	0.00
1	Soffte kompjuterike laboratorit	2,000	0	0.00
II	Ndërtime të reja	285,623	9,048	3.17
1	"Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane " - ish materniteti	30,000	0	0.00
2	Mbikqyrje "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane" - ish materniteti	998	0	0.00
3	Kolaudim - "Ndërtim i ambienteve të tualetit të laboratorit Biokimik në FSHMT"	2	2	94.81
4	Ndërtim - "Shkallë emergjence godinat e UE"	7,075	7,075	100.00
5	Mbikqyrje - "Shkallë emergjence godinat e UE"	137	0	0.00
6	Kolaudim - "Shkallë emergjence godinat e UE"	21	0	0.00
7	"Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT"	217,139	0	0.00
8	Mbikqyrje - "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT"	1,050	0	0.00
9	Oponencë teknike - "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT"	200	0	0.00
10	Efiçenca energjisë në godina- "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT"	1,800	1,796	99.78
11	Taksa (Rilevim topografik)- "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT"	200	175	87.50



Nr.	Emërtimi i projektit	Fondi 000/ lekë		
		Plani	Fakti	%
12	Leje ndertmi - "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT"	27,000	0	0.00
III	Rikonstruksione	35,260	17	0.05
1	Rikonstruksion - "Aspirim kondicionim Godina A , Korpusi Kryesor - fasada xhamit"	12,866	0	0.00
2	Mbikqyerje - "Aspirim kondicionim Godina A, Korpusi Kryesor- fasada xhamit"	258	0	0.00
3	Kolaudim - "Aspirim kondicionim Godina A, Korpusi Kryesor- fasada xhamit"	31	0	0.00
4	Kolaudim - "Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT"	17	17	97.76
5	Rikonstruksion - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C"	21,648	0	0.00
6	Mbikqyerje - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C"	393	0	0.00
7	Kolaudim - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C"	47	0	0.00
IV	Pajisje inventar ekonomik	20,000	18,976	94.88
1	Pajisje kompjuterike/Software e fotokopje	15,000	14,635	97.57
2	Pajisje e orendi për auditore laboratore e zyra	2,880	2,466	85.63
3	Fond libri biblioteka	2,000	1,755	87.77
4	Pajisje pune	120	119	99.16
V	Pajisje profesionale	24,000	0	0.00
1	Pajisje laboratorike	24,000	0	0.00
2	Pajisje e audiovizive, U. Elbasan	0	0	0.00
	Shuma	381,267	41,177	10.80

- ✓ Projekti "Rilevim topografik–‘Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike – FSHMT’" është realizuar për vlerën 175 mijë lekë, ose 87.⁵⁰% e fondeve të planifikuara.
 - ✓ Projekti "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane " - ish materniteti i planifikuar me bashkëfinancim nuk është realizuar, pasi nuk është miratuar financimi nga Buxheti i Shtetit.
 - ✓ Leje ndërtimi - "Ndërtim - "Shkallë emergjence godinat e UE" nuk është realizuar gjatë vitit 2022, pasi është përpunuar dokumentacioni i nevojshëm dhe është dërguar për miratim në Këshillin Kombëtar të Territorit (KKT).
 - Rikonstruksionet janë realizuar në vlerën 17 mijë lekë, ose 0.⁰⁵ % e fondeve të planifikuara;
 - ✓ Projekti "Kolaudim – ‘Aspirim kondicionim Laboratori i Anatomisë në FSHMT’" është realizuar për vlerën 17 mijë lekë, i cili është realizuar në vitin 2021, por subjekti "DEA-N CONSULTING STUDIO" ka prerë faturën 2/2022 datë 21.04.2022 me vlerë 16,780 lekë e cila është likuiduar në maj 2022;
- Projektet e tjera të rikonstruksioneve nuk janë realizuar, pasi nuk janë mundësuar realizimi i procedurave paraprake të dokumentacionit të tyre.
- Pajisjet profesionale (laboratorike) u planifikuan me vlerë 24 milion lekë dhe nuk janë realizuar, pasi për këta laboratorë është paraqitur kërkesa paraprake në periudhën e përgatitjes së buxhetit dhe nuk janë sjellë nga njësitë bazë projektet e konsoliduara të tyre.
 - Pajisjet (inventar ekonomik) janë realizuar në vlerën 18,976 mijë lekë, ose 94.⁸⁸% e fondeve të planifikuara. Në grupin e pajisjeve (inventar ekonomik) janë;
 - ✓ Pajisje kompjuterike e fotokopje janë për vlerën 14,635 mijë lekë, ose 97.⁵⁷% e vlerës së planifikuar,
 - ✓ Pajisje e orendi për auditore laboratore e zyra janë për vlerën 2,466 mijë lekë, ose 85.⁶³% e vlerës së planifikuar,



- ✓ Fond libri për bibliotekën është realizuar për vlerën 1,755 mijë lekë, ose 87.77% e vlerës së planifikuar,
- ✓ Pajisje e vegla pune dore për sektorin e shërbimeve është realizuar për vlerën 119 mijë lekë, ose 99.16% e vlerës së planifikuar.

➤ **Shpenzimet për kërkimin shkencor**

Në Buxhetin e Universitetit për kërkimin shkencor për vitin 2022 janë parashikuar në Planbuxhetin e ndryshuar 130,720 mijë lekë dhe është çelur për përdorim në degën e Thesarit fondi prej 90,293 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 68,874 mijë lekë, ose 76.20% e fondit nga i cili ndahet;

- Kërkim shkencor nga Buxheti i Shtetit është financuar në vlerën 36,513 mijë lekë.
- Fondet për kërkimin shkencor nga të ardhurat e institucionit është financuar në vlerën 53,780 mijë lekë.

Realizimi i kërimit shkencor për vitin 2022 - AKKSHI										
Art	Emërtimi	AKKSHI			Të ardhura			Total Buxheti		
		Plani	Fakt	%	Plani	Fakt	%	Plani	Fakt	%
1	Infrastruktura - PIKSH (230)	0	0	0.0	19,396	19,396	100.0	19,396	19,396	100.0
2	Infrastruktura - PIKSH (231)	25,000	25,000	100.0	0	0	0.0	25,000	25,000	100.0
3	Kërkim zhvillim - PKKZH (602)	11,513	6,487	56.3	30,633	17,618	57.5	42,146	24,104	57.2
4	Kërkim zhvillim - PKKZH (606)	0	0	0.0	3,751	284	7.6	3,751	284	7.6
	Kërkim shkencor	36,513	31,487	86.2	53,780	37,297	69.4	90,293	68,784	76.2

- **Granti konkurrues për kërkim shkencor nga Buxheti i Shtetit.** AKKSHI në procedurën e aplikimeve për financimin e projekteve të kërimit shkencor paraqiti “Thirrje për aplikim për projektet Kombëtare të Kërimit dhe të Zhvillimit (PKKZH) për vitin 2022”, në të cilën afati i fundit i aplikimit ishte data 07.03.2022. Në përgjigje të kësaj thirrje njësitë bazë kanë paraqitur për aplikim dhe u dërguan në AKKSHI nga UE me shkresë nr 584 prot datë 07.03.2022 gjithsej me 12 projekte me vlerë 15,646 mijë lekë e cila:

- Financim nga AKKSHI vlera 13,775 lekë.
- Financim nga të ardhurat e universitetit 1,871 mijë lekë

Nga AKKSHI është çelur fondi në vlerën 36,513 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 31,487 mijë lekë, ose 86.20% e fondit. Fondet e kërimit shkencor të akorduara nga AKKSHI paraqiten të detajuara për çdo projekt në “Tabela 3 - Projekte Kërkimi shkencor – Financim AKKSHI Fakti viti 2022” dhe janë;

- ✓ **Projekte të Infrastrukturës së Kërimit Shkencor – PIKSH** janë realizuar në vlerën 25,000 mijë lekë, ose 100.00% e fondit. Nga AKKSHI me Vendim të Bordit të tij në vitin 2021 është miratuar projekti “Dixhitalizimi i burimeve bibliotekare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe i çelur në Degën e Thesarit për vitin 2021 në kapitullin 1. Për arsye të procedurave të prokurimit nuk u realizua deri në 31.12.2021 lidhja e kontratës. Universiteti i Elbasanit “Aleksander Xhuvani” më datë 16.11.2021 ka zhvilluar procedurën e prokurimit publik për të realizuar projektin me objekt: “Dixhitalizimi i burimeve bibliotekare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”. Për arsye të moslidhjes së kontratës me asnjë operator ekonomik pjesëmarrës në tender pasi nuk rezultuan fitues, Universiteti i Elbasanit bëri anulimin e procedurës së prokurimit me datë 26.11.2021. Rishpallja e procedurës për prokurim nga Universiteti, bazuar në procedurat e prokurimit publik kërkon afat ligjor nga 45 deri në 60 ditë për



zhvillimin dhe realizimin e saj. Gjithashtu Dega e Thesarit nuk konfirmonte hedhjen e procedurës gjatë kësaj periudhe. Për këtë shkak të moslidhjes së kontratës me asnjë operator ekonomik ky projekt nuk mund të zhvillohej dhe realizohej brenda viti 2021.

Bazuar në aktet e zbatimit të buxhetit ky fond nuk trashëgohej për vitin pasardhës, ndërkohë që u ri-kërkua financimi i tij në zbatim të Vendimit të Bordit të AKKSHI. Ky projekt u hartua me bashkëfinancim dhe u realizua në vlerën 45,840 mijë lekë me financim nga AKKSHI në vlerën 25,000 mijë lekë dhe nga Universiteti në vlerën 20,840 mijë lekë.

- ✓ **Projekte Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit – PKKZH.** Nga AKKSHI me Vendim të Bordit të tij në vitin 2021 janë miratuar 4 projekte dhe për vitin 2022 janë miratuar 5 projekte, shtrirja kohore e të cilëve ishte në dy vite buxhetore dhe janë çelur në Degën e Thesarit për çdo vit në kapitullin 8. Bazuar në aktet e zbatimit të buxhetit fondi i papërdorur i vitit 2021 është trashëguar në vitin pasardhës, i cili me financimin e fondit të vitit aktual përbën planin në vlerën 11,513 mijë lekë. Këto projekte për dy vite nga AKKSHI janë financuar për 12,039 mijë lekë janë realizuar në vlerën 7,013 mijë lekë, ose 58.25% e fondit. Duke llogaritur dhe bashkëfinancimin nga UE vlera e këtyre projekteve është 13,413 mijë lekë. Për vitin 2022 këto projekte janë realizuar në vlerën 6,487 mijë lekë ose 56.34% e planit vjetor.
- **Fondet për kërkimin shkencor nga të ardhurat e institucionit** janë çelur në vlerën 53,780 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 37,297 mijë lekë, ose 69.4% e fondit. Në planbuxhetin e vitit 2022 u paraqitën për miratim 58 draftprojekte kërkimore e konferenca, nga të cilat 16 prej tyre u miratuan për financim, ndërsa 42 projete e konferenca ishin në pritje për rishikim të tyre, për tu financuar në momentin e rialokimit të planbuxhetit. Nga projektet e miratuara për financim gjatë kësaj periudhe u realizuan 12 prej tyre, të cilët janë përfunduar ose janë në vijimësi për vitin 2023. Projekti "Dixhitalizimi i burimeve bibliotekare në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"" - Prof. as. Dr. Peçi Naqellari për vlerën 20,840 mijë lekë u realizua bashkëfinancim me projektin PIKSH të AKKSHI-it.. Më të detajuara projektet kërkimore paraqiten "Tabela 4 – Projekte Kërkimi shkencor viti 2022 Realizimuar nga të ardhurat UE"



Nr. (PBA)	Emërtimi i projektit	AKKSHI						Projekti Total		Njesia	
		Totale		Viti 2022		Vlera	AKKSHI	UE			
		Plan	Fakti	%	Plan				Fakti		%
1 (73)	"Dixhitalizimi i burimeve bibliotekare në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" - Prof.as. Dr. Peçi Naqellari	25,000	25,000	100.00	25,000	25,000	100.00	45,840	25,000	20,840	UE
2 (250)	"Mësimdhënia në periudhë pandemie: Zhvillimi i Kapaciteteve Studentore (cikli i dytë i studimeve, Master) gjatë një procesi arsimor të alternuar fizik e në distancë" - Dr. Lenida Lekli	1,264	1,081	85.54	1,176	994	84.49	1,314	1,264	50	FSHH
3 (251)	"Hulumtimi i ndryshimit të modeleve të punësimit (fuqisë punëtore) gjatë dhe pas pandemisë së COVID 19 në qarkun Elbasan" - Prof. as. Dr. Imelda Sejdi	1,933	1,317	68.13	1,792	1,176	65.63	1,990	1,933	58	FE
4 (252)	"Oferta aktuale akademike përkunder kërkesave të bizneseve mbi aftësitë dhe kompetencat e burimeve njerëzore." - Prof. As. Dr. Elvira Fetahu	985	984	99.94	896	895	99.93	985	985	0	UE
5 (253)	"Ndikimi i COVID-19 në organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor; implementimi i një modeli epidemiologjik-matematikor" - Doc.(Dr) Elona Gaxhja	1,790	1,356	75.77	1,582	1,148	72.56	1,790	1,790	0	FSHMT
6 (279)	"Mbi studimin dhe vlerësimin e shëndetit mendor në periudhën post COVID, në grupmoshat 15-24 vjeç." - Dr. Gjergji Kojza	1,529	937	61.28	1,529	937	61.28	2,079	1,529	550	FSHMT
7 (270)	"Studimi i emigrimit tek të rinjtë e qarkut Elbasanit: arsye, kostot dhe mënyrat e zbutjes" - Prof. As. Dr. Alketa Vangjeli	988	256	25.96	988	256	25.96	988	988	0	FE
8 (271)	"Vlerësimi i praktikave profesionale përmes kornizës së kompetencave për studentët kandidatë për mësues" - Prof. As. Dr. Elisabeta Osmanaj	1,334	260	19.46	1,334	260	19.46	1,664	1,334	190	FSHE
9 (273)	"Marrëdhënia midis tipologjive të dhunës në familje dhe variablave psiko-sociale." - Dr.Roksana Poçi	921	272	29.54	921	272	29.54	921	921	0	FSHE
10 (278)	"Evidentimi e vlerësimi floristik i Parkut Kombëtar "Shebenik" si dhe ngritja e kapaciteteve bashkëpunuese me Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Elbasan.." - Dr. Ermelinda Gjeta	1,296	549	42.39	1,296	549	42.39	1,702	1,296	406	FSHN
Shuma		37,039	32,013	86.43	36,513	31,487	86.24	59,272	37,039	22,094	





Tabela Nr. 25-2: Për realizimin faktik të buxhetit nga Granti i punës Kërkimore shkencore dhe punës krijuese – të ardhurat UE 0000/Lekë

	Emërtimi projektit	UE						Njesia
		Gjithsej		Art. 230		Art. 602		
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	
1 (68)	Ndërtimi i Database-së Universitetit për menaxhimin e të dhënave - mirembajtje	15,000	12,762	0	0	15,000	12,762	UE
2 (73)	"Dixhitalizimi i burimeve bibliotekare në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"" - Prof. as. Dr. Peçi naqellari	22,892	20,840	20,591	19,396	2301	1,444	UE
3 (145)	"Konferenca i 11-të Mjekësore ndërkombëtar në specialitete" - Prof. as. Dr. Shkëlqim Hidri	2,300	0	0	0	2,300		FSHMT
4 (163)	"Konferenca e parë shkencore ndërkombëtare në matematikë e fizikë. Zbatime të tyre në fusha të ndryshme" - Prof. as. Dr. Bederiana Shyti, Dr. Blerina Papajani	650	372	0	0	650	372	FSHN
5 (187)	"Globalizimi dhe integrimi në edukimin bashkëkohor" - Prof. As. Dr. Elisabeta Osmanaj	900	457	0	0	900	457	FSHE
6 (213)	"Kërkimi modern dhe tendencat në ekonomi, legjisllacion dhe politika sociale" - Konferenca e 10-të Ndërkombëtare - Prof. As. Dr. Imelda Sejdimi	600	539.8	0	0	600	540	FE
7 (223)	"Kujtesa kolektive në letërsi dhe media" - Dr. Nirvana Meça	300	229.348	0	0	300	229	FSHH
8 (227)	"Konferenca e 6-të Ndërkombëtare infermierore në Specialitete" - Dr. Elona Gaxhja	600	395	0	0	600	395	FSHMT
9 (231)	"Elbasani në vitet 1945-1955 -dokumente arkivore" - Prof. As. Dr. Majlinda Peza, Dr. Florenca Stafa	658	25	0	0	658	25	FSHH
10 (237)	"Sfidat e kërkimit shkencor në psikologjinë e aplikuar dhe edukimi" Prof.As.Dr. Lindita Durmishi	400	311.95	0	0	400	312	FSHE
11 (239)	"Konferenca nderkombetare në ruajtjen e qëndrueshmërisë së ekosistemeve ujore nëpërmjet njohurive shkencore" - Prof. Dr. Sotir Mali	650	312.795	0	0	650	313	FSHN
12 (251)	"Hulumtimi i ndryshimit të modeleve të punësimit (fuqisë punëtore) gjatë dhe pas pandemisë së COVID 19 në qarkun Elbasan"- Prof. as. Dr. Imelda Sejdimi	58	0	0	0	58	0	FE
13 (254)	"Një vlerësim numerik i bashkëjetesës fetare dhe veprimtarisë së Komuniteteve Fetare në Biznes: Rasti studimor i Shqipërisë" - Dr. Ardita Todri	400	0	0	0	400	0	FE
14 (256)	"Veprat penale lidhur me COVID-19" - Prof.As. Rezarta Tahiraj	200	0	0	0	200	0	FE
15 (259)	"Elbasani dhe Arsimi Kombëtar (mesi i shek XIX deri në vitet 20-30 të shek XX)" - Prof. as. Rudina Mita	360	48.95	0	0	360	48.95	FSHH
16 (260)	"Konferencë Ndërkombëtare studentore për shkencën e hapur dhe ndërkombëtarizimin" - Prof.As. Elvira Fetahu	800	607	0	0	800	607	UE
Totali		46,768	36,900	20,591	19,396	26,177	17,505	



c.2. Plani buxhetor i vitit pasardhës akademik - viti 2022 – 2023

Hartimi i planbuxhetit të vitit 2023 është bazuar në projektet e paraqitura në periudhën e hartimit të p/buxhetit 2023-2025, në ndryshimet e ndodhura pas miratimit të tij; strukturën organizative, programet e studimit, numrin e studentëve të regjistruar në vijimësi, numrin e studentëve të padiplomuar, realizimit të planbuxhetit të mëparshëm, fondeve të trashëguara të papërdorura nga vitet e mëparshme, nivelin e financimit nga Buxheti i Shtetit. Tërësia e financimeve dhe përdorimi i tyre për mbarrëvajtjen e aktivitetit të funksionimit të Universitetit, përbën buxhetin e vitit 2023 në vlerën **2,065,695 mijë lekë**. Buxheti i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për vitin 2023, u miratua me Vendim të Senatit Akademik Nr. 04 , datë 17.03.2023 “Për miratimin e planbuxhetit vjetor 2023” dhe Vendim të Bordit të Administrimit Nr. 10 , datë 24.04.2023 “Për miratimin e planbuxhetit vjetor 2023” dhe paraqetet në mënyrë analitike si më poshtë:

Fonde të mbartura, financimet, Granti dhe të ardhurat për vitin 2023 Plani				000/lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2022	Financimi vitit 2023	Buxheti i vitit 2023
1	Financimi nga Buxheti i Shtetit	475,033	966,804	1,441,837
2	Disbursimet për projektet me financim të huaj	5,054	30,137	35,191
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	418,667	170,000	588,667
TOTALI		898,754	1,166,942	2,065,695

Gjatë vitit 2023 plani i financimeve nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurave pati ndryshime të cilat u reflektuan me ndryshim të vendimeve të mësipërme. Pas këtyre ndryshimeve Planbuxheti i vitit 2023 paraqitet.

Tabela. Nr. 27 -1: Plani Buxhetor i vitit pasardhës akademik – të ardhurat në UE				000/lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2022	Financimi vitit 2023	Buxheti i vitit 2023
1	Financimi nga Buxheti i Shtetit	475,033	1,063,956	1,538,989
2	Disbursimet për projektet me financim të huaj	5,054	30,616	35,671
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	418,667	-153,747	264,919
TOTALI		898,754	940,825	1,839,579
1	Financimi nga Buxheti i Shtetit	475,033	1,063,956	1,538,989
1.1	Granti mësimdhënies	446,256	925,222	1,371,478
1.2	Granti i bursave të studentëve cikli parë	23,751	124,380	148,131
1.3	Mbështetje financiare nga fondi ekselences	0	680	680
1.4	Granti Konkurrues	0	0	0
1.5	Granti Kërkimit shkencor PKKZH	5,026	7,477	12,503
1.6	Granti Kërkimit shkencor infrastruktura PIKSH	0	5,785	5,785
1.7	TVSH- Projekte të huaja	0	412	412
2	Disbursimet për projektet me financim të huaj	5,054	30,616	35,671
2.1	Disbursime të huaja për shpenzime korente	5,054	29,166	34,220
2.2	Disbursime të huaja për investime	0	1,450	1,450
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	418,667	-153,747	264,919
3.1	Të ardhura për shpenzime korente	74,891	30,000	104,891
3.2	Të ardhura për investime	312,876	-200,664	112,212
3.3	Të ardhura për kërkim shkencor	30,900	16,917	



Buxheti i ndarë, sipas periudhave të financimit;

- Fondet e trashëguara të papërdorura nga vitet e mëparshme në vlerën **898,754 mijë lekë**,
- Hyrjet e fondeve për vitin 2023 në vlerën **940,825 mijë lekë**.

Buxheti i ndarë, sipas formave të financimit;

- Financimi nga Buxheti i Shtetit në vlerën **1,538,989 mijë lekë**. Fondi i mbartur nga vitet e mëparshme është në vlerën **475,033 mijë lekë** dhe financimi për vitin është në vlerën **1,063,956 mijë lekë**.
- Disbursimet nga projektet me financim të huaj në vlerën **35,671 mijë lekë**. Projektet e huaja në bankën e nivelit të dytë, janë me gjendje bankare në vlerën **5,054 mijë lekë** dhe parashikohet të disbursohen gjatë vitit në vlerën **30,616 mijë lekë**.
- Të ardhurat e vetë institucionit janë në vlerën **588,667 mijë lekë**. Sipas aktrakordimit me Degën e Thesarit Elbasan fondi i papërdorur në vitin 2022 nga të ardhurat e vetë institucionit të çelura për përdorim, si edhe grumbullimi i tyre gjatë vitit, por i trashëguar është në vlerën **418,667 mijë lekë**. Këto fonde, sipas përcaktimeve në udhëzim janë proceduar për përdorimin e tyre në vitin 2023. Gjatë vitit 2023 është parashikuar të grumbullohen të ardhura në vlerën **170,000 mijë lekë**. Plani i vitit 2023 është me ndryshimet gjatë vitit parashikohet në vlerën **264,919 mijë lekë**, duke transferuar për përdorim në vitet pasardhëse vlerën 153,747 mijë lekë për dërtimin e godinës së FSHMT

Buxheti i mbartur nga vitet e mëparshme dhe hyrjet e fondeve për vitin 2023

Buxheti i Universiteteve publike përbëhet nga financimet (fondet) në fomën e granteve, disbursimeve nga institucione të ndryshme (ndërkombëtare, publike apo biznese private) dhe të ardhurat e vetë institucionit:

Buxheti i mbartur nga vitet e mëparshme: Fondet e mbartura nga viti 2022 janë në vlerën **898,754 mijë lekë** dhe janë të disponueshme për përdorim në Degën e Thesarit dhe në Bankën e Nivelit të Dytë (projektet me financim të huaj) dhe përbëhet nga:

- Fonde të mbartura të financuara nga Buxheti i Shtetit në vlerën **475,033 mijë lekë**. Këto fonde janë për projektet e kërkimit shkencor (PKKZH) në proces, të financuara nga AKKSHI në vitin 2021 dhe në vitin 2022.
- Fondet e projekteve me financim të huaj të depozituara në bankën e nivelit të dytë. Këto fonde në vlerën **5,054 mijë lekë**, përfaqësohen nga gjendja në bankë në fund të vitit në llogarinë speciale të secilit projekt në monedhën vendase (*mbartja e fondeve nga viti paraardhës në vitin korent, bazohet në aktet e cituara më lart*).
- Të ardhurat e trashëguara të institucionit (Universitetit) në vlerën **418,667 mijë lekë**; të autorizuar për përdorim gjatë vitit në artikuj të ndryshëm buxhetor e të papërdorura në vlerën 344,919 mijë lekë, të grumbulluara gjatë vitit 2022 dhe të pa autorizuar për përdorim në vlerën 73,748 mijë lekë;

Hyrjet e fondeve për vitin 2023 janë parashikuar në vlerën **1,063,956 mijë lekë**, të cilat përfshijnë

- Fondet e financuara nga Buxheti i Shtetit të cilat janë në vlerën **966,804 mijë lekë**; fondet e miratuara dhe të depozituara për përdorim në Degën e Thesarit në vlerën 965,712 mijë lekë (detajuar me VBA nr. 1 datë 09.01.2023) dhe 680 mijë lekë për t'u detajuar sipas Projektvendim për detajimin e "Mbështetjes financiare nga fondi ekselences për vitin 2023". Financimi i pritshëm TVSH-së projekteve me financim të huaj në vlerën 412 mijë lekë.

➤ Parashikimi i disbursimit nga donatorët për projektet me financim të huaj në vlerën **30,137 mijë lekë** (bazuar në marrëveshjet për secilin projekt);

- Të ardhurat të institucionit të parashikuara për tu grumbulluar në vlerën **170,000 mijë lekë**.



Në planifikimin e grumbullimit të ardhurave janë marrë; të dhënat mbi numrin e studentëve, tarifatat e shkollimit, sipas niveleve të studimit për vitin akademik 2022-2023. Gjithashtu ndikojnë:


Nr.	Emërtimi	Lekë
1	Qira	350
2	Programe profesionale	9,240
3	Bachelor	44,518
4	DIND	2,955
5	Master profesional	39,722
6	Master i shkencave	52,479
7	Trajnim mësues	4,350
8	Doktoraturë	500
9	Libreza Diploma etj.	3,397
10	Lëshim dokumenti	4,158
11	Taksë regjistrimi	4,331
12	Tarifa konkurimi	500
13	Tjera - shërbime	2,000
14	Pjesm. konferenca	500
15	Sponsorizime	1,000
a-	Të ardhurat e vitit	170,000

- Pagesa për kreditet e mbartura të studentëve që kanë përfunduar vitet e përcaktuara të programit të studimit, por nuk janë diplomuar, kryesisht studentët që kanë përfunduar; vitin e dytë në programet profesionale dy-vjeçare, vitin e tretë në programet e Ciklit të parë Bachelor, vitet përkatëse të studimit në Ciklin e dytë.
- Shpërndarja librezave e diplomave.
- Tarifa e regjistrimit të studentëve të parashikuar për regjistrim në vitin akademik 2021 – 2022
- Tarifa konkurimi të parashikuar për vitin akademik 2021 – 2022

- Të ardhurat nga dhënia me qira e objekteve (janë parashikuar për 2 mjedise, një Bar kafe, pa tregtim pije alkoolike dhe një Librari Universitare, si dhe pagesat për mjediset që përdoren për kurset e gjuhëve të huaja, të cilat kryhen nga shoqata të licensuara.)
- Të tjera të ardhura (shërbime laboratorit, vërtetime diplomimi, certifikatë notash etj.)

Sipas ndarjeve kryesore në të ardhurat e institucionit peshën specifike e zënë:


- Tarifatat e shkollimit janë 91.00% e të ardhurave gjithsej,
 - Të ardhura nga shërbimet janë 5.90% e të ardhurave gjithsej,
 - Tarifa regjistrimi janë 2.60% e të ardhurave gjithsej,
 - Tarifa konkurimi janë 0.30% e të ardhurave gjithsej,
 - Qira janë 0.20% e të ardhurave gjithsej,
- Ndërsa sipas grupimve më të detajuara të ardhurat ndahen;



- Të ardhura “Qira”, janë të ardhurat nga dhënia me qira e mjediseve të UE-së subjekteve të treta për shërbime ndaj studentëve dhe personelit akademik dhe zenë 91.00% e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura “Programe profesionale” janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të shkollimit të studentëve në programet e studimit me karakter profesional dhe zenë 5.40% e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura “Bachelor”, janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të shkollimit të studentëve në programet e studimit në bachelor dhe zenë 26.20% e të ardhurave gjithsej,



- Të ardhura “DIND”, janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të shkollimit të studentëve në programet e studimit për diplomë e integruar e nivelit të dytë dhe zenë 1.70% e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura “Master profesional”, janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të shkollimit të studentëve në programet e studimit në master profesional dhe zenë 23.40% e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura “Master i shkencave”, janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të shkollimit të studentëve në programet e studimit në master i shkencave dhe zenë 30.90% e të ardhurave gjithsej,




- Të ardhura “Trajnim i mësuesve”, janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të krediteve që paguajnë mësuesit e arsimit parauniversitar për trainim profesional të tyre pranë FSHE-s dhe zenë 0.30% e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura “Doktoraturë”, janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të shkollimit doktorantëve dhe zenë 2.60% e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura “Libreza Diploma etj.”, janë të ardhurat nga pagesa e tarifës së diplomës dhe certifikatës së notave dhe blerja e librezës së studentit që regjistrohet për herë të parë dhe zenë 2.00% e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura “Lëshim dokumenti”, janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të shërbimeve ndaj studentëve që kanë përfunduar studimet; vërtetim diplomimi, certifikatë notash dublikatë, programe studimi etje. dhe zenë 2.40% e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura “Taksë regjistrimi”, janë të ardhurat nga pagesat e takasve të regjistrimit në të gjitha programet e studimit dhe zenë 2.50% e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura “Tarifa konkurimi”, janë të ardhurat nga pagesat e tarifave të konkurimit në programin e studimit “Edukim fizik e sporte” për konkursin e pranimit dhe zenë 0.30% e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura “Tjera – shërbime”, janë të ardhurat nga pagesa për shërbimeve ndaj tretëve kryesisht analizave që kryen Laboratori kërkimor në FSHN, i akredituar nga institucione ndërkombëtare dhe zenë 1.20% e të ardhurave gjithsej,



- Të ardhura “Pjesm. Konferenca”, janë të ardhurat nga pagesa e tarifës për pjesëmarrje në konferenca shkencore, të cilët përfitojnë kredite të profesionit të tyre dhe zenë 0.³⁰% e të ardhurave gjithsej,
- Të ardhura “Sponsorizime”, janë të ardhurat nga sponsorizimet e institucioneve universitare ndërkombëtare në kuadrin e projekteve ERASMUS+ dhe zenë 0.⁶⁰% e të ardhurave gjithsej,

Përdorimi i të ardhurave është detajuar me grup shpenzimesh, sipas natyrës së mbarëvajtjes së procesit akademik e administrativ të Universitetit dhe do të përdoren:



Përdorimi i të ardhurave, viti 2023

- Investime në infrastrukturë e pajisje në masën 73.⁸⁰ %
- Studime e projektme në masën 0.⁴⁰ %
- Patenta, softje kompjuterike në masën 0.³⁰ %
- Paga në masën 5.³⁰ %
- Sigurime shoqërore në masën 0.⁸⁰ %
- Shpenzime operative në masën 3.³⁰ %
- Transferta tek individë; rimbursim tarifa të paguara nga studentët, dalje në pension, shpërblim raste fatkeqësie etje në masën 3.¹⁰ %
- Transferta me jashtë në masën 0.²⁰ %
- Kërkim shkencor në masën 12.⁸⁰ %
 - Kërkim shkencor (art. 602) në masën 12.⁰⁰ %
 - Kërkim shkencor (art. 606) në masën 0.⁸⁰ %

Në krahasim me realizimin e vitit 2022 të ardhurat e planifikuara janë në rritje, ndërsa me parashikimin në P/Buxhetin afatmesëm të vitit 2023 – 2025 të ardhurat janë në ulje me 12.7 % e planifikimit të PBA-së për vitin 2023. Ulja vjen si rezultat:



- Reduktimi i tarifave të shkollimit ose heqja e pagesës së tyre, nga zbatimi i VKM – ve për këtë qëllim.
- Ulja e numrit të studentëve në disa programe studimi.
- Në ciklin e parë e të dytë të studimit për vitin e parë nuk janë hapur disa programe studimi, pasi nuk u plotësua numri minimal i parashikuar.

Në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, kostoja e një studenti mbi bazën e të cilës referohet vendosja e tarifave të shkollimit, që duhet të paguajë studenti, rezulton më e lartë se Universitetet e tjera rajonale, ndërkohë që tarifa e shkollimit nuk mund të jetë më e lartë se kufiri maksimal i vendosur me VKM-n nr. 288 datë 21.05.2018 *“Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”*, të ndryshuar.

Me vendime të Bordit të Administrimit dhe VBA nr. 10 datë 09.03.2022 *“Për vendosjen e tarifave të shkollimit në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Elbasanit ‘Aleksandër Xhuvani’”* janë vendosuar tarifat e shkollimit, tarifat e tjera

Efektet në ulje e të ardhurave të llogaritura në buxhetin e vitit 2023, nga arkëtimi i pagesës së tarifave të shkollimit, sipas të dhënave për aplikimet e studentëve për reduktim dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të raportuara në BA, për të cilat është shprehur me vendim, si dhe ratet e kërkesave me të dhënat për vendimarrje, në zbatim të VKM-ve dhe akteve të tjera, që rrjedhin prej tyre, paraqiten në tabelën “Efektet e VKM-ve - Për studentë që përfitojnë përjashtim apo reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2022-2023” dhe kanë efekt financiar në vlerën 62,936 mijë lekë:

- **Cikli parë i studimeve + PiMs** me një efekt financiar në vlerën totale 54,290 mijë leke
 - a.1 Reduktim tarife me 50% për studentët e programeve të studimit me karakter profesional dhe programeve të studimit bachelor që janë regjistruar në vitin 2022 në vitin e parë dhe studentët e këtyre programeve të vitit të dytë e të tretë që rezultojnë me mesatë mbi 6-të në vitin paraardhës me efekt financiar në vlerën 16,500 mijë lekë
 - a.2 Reduktim tarife me 50% për studentët e programeve të studimit DIND, që janë regjistruar në vitin 2022 në vitin e parë dhe studentët e këtij programi në vitin e dytë e të tretë që rezultojnë me mesatë mbi 6-të në vitin paraardhës me efekt financiar në vlerën 990 mijë lekë
- b.1 Përjashtimet nga tarifat e shkollimit me rezultate -Bach+2vj me një efekt financiar në vlerën 2,375 mijë lekë
- b.2 Përjashtimet nga tarifat e shkollimit me rezultate -DIND me një efekt financiar në vlerën 450 mijë lekë
- c.1 Përjashtimet nga tarifat e shkollimit kritere tjera -Bach+2vj me një efekt financiar në vlerën 32,625 mijë lekë
- c.2 Përjashtimet nga tarifat e shkollimit kritere tjera -DIND me një efekt financiar në vlerën 1,350 mijë lekë
- **Cikli dytë i studimeve me një efekt financiar në vlerën totale 8,646 mijë leke**
 - Master profesional me efekt financiar në vlerën 3,210 mijë leke
 - 1.1. Reduktim tarife me 50% me rezultate me një efekt financiar në vlerën 660 mijë lekë
 - 1.2. Reduktim tarife me 50% me kritere tjera me një efekt financiar në vlerën 2,550 mijë lekë
 - Master i shkencave me efekt financiar në vlerën 5,436 mijë leke
 - 2.1. Reduktim tarife me 50% me rezultate me një efekt financiar në vlerën 2,160 mijë lekë
 - 2.2. Reduktim tarife me 50% me kritere tjera me një efekt financiar në vlerën 3,276 mijë lekë



Efektet e VKM-ve - Për studentë që përfitojnë përjashtim apo reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2022-2023

000/lekë

Nr.	DEGA	I parë			I dytë			I tretë			Total		
		Nr st	Tarifa	Vlera	Nr st	Tarifa	Vlera	Nr st	Tarifa	Vlera	Nr st	Tarifa	Vlera
a.1	Reduktim tarife me 50% - Bach&Prof 2v (Viti I + Messatare >6 Viti II&III)	816	12,500	10,200	325	12,500	4,063	179	12,500	2,238	1,320	12,500	16,500
a.2	Reduktim tarife me 50% - DIND (Viti I + Messatare >6 Viti II&III)	25	15,000	375	17	15,000	255	24	15,000	360	66	15,000	990
b.1	Përjashtimet nga tarifat e shkollimit me rezultate - Bach+2vj	35	25,000	875	28	25,000	700	32	25,000	800	95	25,000	2,375
b.2	Përjashtimet nga tarifat e shkollimit me rezultate -DIND	4	30,000	120	7	30,000	210	4	30,000	120	15	30,000	450
c.1	Përjashtimet nga tarifat e shkollimit kriteret tjera - Bach+2vj	473	25,000	11,825	513	25,000	12,825	319	25,000	7,975	1,305	25,000	32,625
c.2	Përjashtimet nga tarifat e shkollimit kriteret tjera -DIND	4	30,000	120	22	30,000	660	19	30,000	570	45	30,000	1,350
I	Cikli parë i studimeve + DIND Totali	1,357		23,515	912		18,713	577		12,063	2,846		54,290
1.1	Reduktim tarife me 50% me rezultate	5	30,000	150	17	30,000	510	0	0	0	22	30,000	660
1.2	Reduktim tarife me 50% me kriteret tjera	63	30,000	1,890	22	30,000	660	0	0	0	85	30,000	2,550
II.1	Total MP	68		2,040	39		1,170	0	0	0	107	60,000	3,210
2.1	Reduktim tarife me 50% me rezultate	21	36,000	756	39	36,000	1,404	0	0	0	60	36,000	2,160
2.2	Reduktim tarife me 50% me kriteret tjera	45	36,000	1,620	46	36,000	1,656	0	0	0	91	36,000	3,276
II.2	Total MSH	66		2,376	85		3,060	0	0	0	151	72,000	5,436
II	Cikli dytë i studimeve Totali	134		4,416	124		4,230	0		0	258	0	8,646
	Total UE	1,491	0	27,931	1,036	0	22,943	577	0	12,063	3,104		62,936

Shpenzimet për vitin 2023. Buxheti i shpenzimeve të vitit 2023 mbulohet nga të hyrat e fondeve në universitet, të cilat janë aktive për përdorim në degën e Thesarit ose Bankën e nivelit të dytë, si dhe ato fonde që parashikohet të grumbullohen (të ardhurat) dhe parashikohet të disbursohen nga donatorët, duke i ndarë sipas zërave të shpenzimeve buxhetore. Për ndarjen e shpenzimeve, sipas zërave në nivel tre shifrorë (shih tabela Plan Buxheti i Shpenzimeve për vitin 2023), jemi nisur nga:

- Ndarja e tyre në p/buxhetin e vitit 2023 duke reflektuar ndryshimet e ndodhura, pas miratimit.
- Ndryshimet e ndodhura në zbatim të akteve n/ligjore.
- Në numrin e punonjësve e kualifikimin e tyre, ndryshimet në strukturë, aktet ligjore e n/ligjore për pagesat e tyre,
- Numrin e studentëve dhe orët mësimore të pagueshme për mbulimin e procesit mësimor;

➤ **Paga e shpërblime – Artikulli 600.**

Universitetit i nevojitet fond page rreth 579,809 mijë lekë, sipas përlogaritjeve në PBA 2023-2025 me ndryshimet e ndodhura pas kësaj periudhe në; numrin e punonjësve e kualifikimin e tyre, parashikimin e orëve mësimore për vitin akademik 2022-2023, nivelin e pagave të punonjësve dhe pagesës për orët mësimore të procesit akademik. Ky fond pagash ndahet:

- për pagat mujore të personelit në vlerën 472,020 mijë lekë



- për pagesën e orëve mësimore 107,789 mijë lekë.

Tabela. Nr. 27 -2: Plani Buxhetor i vitit pasardhës akademik – Shpenzimet në UE						000/lekë
Nr	Emërtimi shpenzimit	Artik.	Grant	Projekte huaja	Limiti të ardhura institucionit	Total Buxheti
1	Paga e shperblime	600	1,041,461	0	61,000	1,102,461
-	Pagat	600	915,563	0	59,446	975,009
-	Honorare - oret	600	125,898	0	1,554	127,452
2	Sig. Shoqërore	601	99,257	0	4,876	104,133
3	Shpenzime operative	602	210,025	0	19,364	229,389
4	<i>Transf. me jashtë</i>	605	0	0	900	900
5	<i>Transf. individet</i>	606	20,735	0	18,750	39,485
6	<i>Bursat financiare</i>	606	148,131	0	0	148,131
7	<i>Fondet e ekselencës</i>	606	680	0	0	680
8	Kërkimi shkencor		18,288	0	47,817	66,105
-	Kërkimi shkencor	230	0	0	0	0
-	Kërkimi shkencor	231	5,785	0	5,454	11,239
-	Kërkimi shkencor	602	12,503	0	37,907	50,410
-	Kërkimi shkencor	606	0	0	4,456	4,456
9	Investime	230/231	412	0	112,212	112,624
a	Studim projektive, soffte	230	0	0	4,500	4,500
-	Studime e projektive	230	0	0	2,500	2,500
-	Patenta, soffte kompjuterike	230	0	0	2,000	2,000
b	Investime trupëz.	231	412	0	107,712	108,124
-	Ndërtime të reja	231	0	0	29,525	29,525
-	Rikonstrukcione	231	0	0	37,686	37,686
-	Instalime rrjete	231	0	0	0	0
-	Makineri teknologjike	231	0	0	0	0
-	Paisje profesionale	231	0	0	15,000	15,000
-	Paisje inventar ekonomik	231	0	0	19,000	19,000
-	TVSH projekte pajisje	231	412	0	0	412
-	Mjete transporti	231	0	0	6,500	6,500
10	Projekte të huaja	230-231-602	0	35,671	0	35,671
-	Shpenzime korentë	604	0	34,220	0	34,220
-	Shpenzime Investime	231	0	1,450	0	1,450
-	Disbursim i projekt huaj	231	0	0	0	0
	Totali		1,538,989	35,671	264,919	1,839,579

Fondi i pagave gjithsej i përlogaritur në Planbuxhetin e vitit 2023 është në vlerën 988,572 mijë lekë do të mbulojë:

- Fondin e pagave për nevoja të procesit akademik e administrativ është në vlerën 861,120 mijë lekë
- Fondin e pagave për pagesën e orëve mësimore të parashikuara për t'u realizuar në vitin akademik 2022-2023 nga personeli akademik është në vlerën 127,452 mijë lekë.

Fondi i pagave është detajuar të përballohet nga financimi i:

- Grantit për shpenzime korrente për paga në vlerën 957,572 mijë lekë
 - Paga e detyrime të tjera që lidhen me pagat 831,674 mijë lekë
 - Shpërblime për orët e zhvilluara në procesin akademik nga personeli akademik i brendshëm e i ftuar në vlerën 125,898 mijë lekë
- Të ardhurat e institucionit në vlerën 31,000 mijë lekë. Fondi i pagave nga të ardhurat e institucionit do të shpenzohet për:

Pagat e punonjësve në vlerën prej 29,446 mijë lekë.



- Shpërblime për orët e zhvilluara në procesin akademik nga punonjësit e brendshëm e të jashtëm në vlerën prej 1,554 lekë.

Pagesa e orëve suplementare dhe pedagogë të jashtëm					000/lekë
Nr	Emërtimi i pagesës	Ore	Vlera	Sig. Shoq	Shuma
1	Pagesa e pedagogëve brendshëm	76,800	78,308	13,077	91,385
2	Pagesa e pedagogëve jashtëm	27,236	29,555	4,936	34,491
-	Orë viti 2022-2023 jashtëm	25,736	27,928	4,664	32,592
-	Orë viti 2021-2022 jashtëm	1,500	1,628	272	1,900
3	Pagesa e pedagogëve trajnues	1,200	1,554	22	1,576
	Totali fondi	105,236	109,417	18,035	127,452

Me fondin e pagave të planifikuar do të përballohet paga mujore për punonjësit e planifikuar sipas organikës së miratuar për 389 punonjës. Gjithashtu me këtë fond do të paguhet pagesa e orëve suplementare mbi normën e përcaktuar në Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”. Personelit akademik të punësuar me kohë të plotë mund t’i paguhet deri në 300 orë suplementare të realizuara mbi normën e ngarkesës në auditor, pasi të ketë përmbushur kohën minimale vjetore të punës prej 1,536 orë.

Pranë FSHE-së me vendim të Senatit Akademik funksionon sistemi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë për të cilin me VBA nr. 4, datë 21.02.2018 “Për funksionimin e sistemit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, përcaktohen modalitetet financiare dhe pagesa për kredit të punonjësve arsimor që do të trajnohen. Fondi i pagave nga të ardhurat e institucionit është përlogaritur për të përbaluar efektet financiare nga zbatimi i VBA nr.30, datë 04.11.2022 “Për miratimin në kufirin maksimal të pagave të personelit akademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për secilin pozicion pune.”, pika 1), “Miratimin në kufirin maksimal të pagave të personelit akademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (sipas Lidhjes nr. 1, pikës II. 2) në VKM-n nr. 647, datë 05.10.2022 ‘Për disa ndryshime në VKM nr. 748 datë 11.06.2009 ‘Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë’, i ndryshuar’”. Ndërsa pika 2) e VBA-s së mësipërme, “Burimi i financimit nga kufiri minimal deri në kufirin maksimal të përballohen nga të ardhurat që realizon UE për shërbimet ndaj të tretëve në; Laboratorin kërkimor FSHN, të ardhurat nga të tretë (të diplomuarit në këtë universitet) për programe mësimore, vërtetim note pas diplomimit (dublikatë), tarifave të aplikimit në master, tarifave të regjistrimit, qira e mjediseve etje.”

➤ Sigurime shoqërore e shëndetësore – Artikulli 601

Fondi i llogaritur për sigurime shoqërore në vlerën 104,133 mijë lekësh përballon nevojat deri në fund të vitit. Krahas efektit nga rritja e pagave, për llogaritjen e këtij fondi është parashikuar edhe mundësia e rritjes së nivelit maksimal të pagës për kontribut.

Fondi i sigurimeve shoqërore do të përballohet nga granti në vlerën 99,257 mijë lekë dhe nga të ardhurat e institucionit në vlerën 4,876 mijë lekë për efektet financiare nga zbatimi i VBA nr.30, datë 04.11.2022.

➤ Shpenzime operative – Artikulli 602

Shpenzimet operative janë planifikuar sipas parashikimeve në p/buxhetin e vitit 2023 me disa ndryshime, duke reflektuar realizimin e procedurave të prokurimit publik në fund të vitit 2022 dhe kërkesat e paraqitura nga strukturat bazë për vitin 2023. Këto shpenzime janë planifikuar në vlerën 229,389 mijë lekë. Ky shpenzim do të përballohet nga:

- Granti për mësimdhënie janë detajuar shpenzime operative në vlerën 210,025 mijë lekë për përballimin e shpenzimeve të drejtpërdrejta: Ujë, energji, telefon, shërbime ruajtje, pagesa e



anëtarëve të Senatit Akademik, pagesa e anëtarëve të Bordit të Administrimit e shpenzime të tjera operative.

- Të ardhurat e vetë institucionit në vlerën 19,364 mijë lekë.

Planifikimi në këto nivele do të mundësojë përballimin e shpenzimeve në rritje në disa zëra, si: energji, ujë, telefon; në shërbimet që dalin të detyruara, si p.sh.: Shpenzimet për ekspeditat me studentët dhe praktikave mësimore në terren, shpenzimet për sinjalin e internetit, shpenzimet për shërbimin e ruajtjes e sigurisë, shpenzime për mirëmbajtje të godinave e pajisjeve etj.. Funksionimi i sistemit të ngrohjes qendrore në tërë godinat paraqet nevojën për shpenzime për lëndë djegëse. Ndarjen për çdo artikull e kemi llogaritur duke u nisur nga fakti i artikujve të vitit të kaluar, si dhe nga kërkesat për disa lloj shpenzimesh.

<i>Shpenzime për mallra dhe shërbime (602- shpenzime operative) viti 2022</i>				
Llog.	Shenime	Grant	Të ardhura	Totali
6020	Materiale zyre dhe të përgjithshme	10,977	360	11,337
6021	Materiale dhe shërbime speciale	14,500	600	15,100
6022	Shërbime nga te trete	90,474	1,720	92,194
6023	Shpenzime transporti + lëndë djegese për ngrohje	7,200	240	7,440
6024	Shpenzime udhëtimi	15,000	0	15,000
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	32,800	240	33,040
6026	Shpenzime për qiramarrje	4,200	480	4,680
6029	Shpenzime të tjera operative	34,874	15,724	50,598
Totali		210,025	19,364	229,389

Grupi “Shpenzime udhëtimi” përfshin pagesën për: udhëtim e dieta brenda vendit, jashtë vendit dhe për ekspeditat me studentët dhe praktikave mësimore në terren. Udhëtim e dieta brenda vendit zë një peshë specifike shumë të vogël, për shkak të përcaktimeve në VKM për këtë qëllim. Për udhëtim e dieta jashtë vendit është përlllogaritur mbulimi i shpenzimeve për pjesëmarrje në zbatimin e marrëveshjeve me universitet e huaja. Peshën kryesore në “shpenzime udhëtimi” e zënë shpenzimet për ekspeditat me studentët dhe praktikave mësimore në terren.

Më të detajuar zërat e shpenzimeve janë në tabelën e mëposhtme:

Tabela 27.3		<i>Shpenzime për mallra dhe shërbimetë detajuara Plan viti 2023</i>		000/lekë	
Kodi llog	Grup shpenzimi	Grant	Të ardhura	Totali	
602.0	Materiale zyre dhe të përgjithshme	10,977	360	11,337	
6020100	Kancelari	7,400	0	7,400	
6020200	Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	2,377	0	2,377	
6020300	Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës	0	120	120	
6020400	Materiale për funksionimin e pajisjeve speciale	0	120	120	
6020500	Blerje dokumentacioni	1,200	0	1,200	
6020900	Furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme	0	120	120	
602.1	Materiale dhe shërbime speciale	14,500	600	15,100	
6021001	Uniforma dhe veshje të tjera speciale	1,200	0	1,200	
6021002	Plehra kimike, furnitura veterinare, farera, fidane e të tjera produkte agrokulturore	0	120	120	
6021003	Ilaçe, materiale dhe proteza mjekësore	0	120	120	
6021007	Libra dhe publikime profesionale	1,200	0	1,200	
6021008	Materiale për mbrojtjen e tokës, bimëve dhe kafshëve nga semundjet	0	120	120	
6021009	Materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik	960	120	1,080	
6021010	Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik	4,940	0	4,940	
6021011	Softe informatike me karakter të përgjithshëm	1,200	0	1,200	
6021099	Të tjera materiale dhe shërbime speciale	5,000	120	5,120	
602.2	Shërbime nga te trete	90,474	1,720	92,194	
6022001	Elektricitet	10,000	0	10,000	
6022002	Ujë	8,000	0	8,000	
6022003	Shërbime telefonike	1,500	0	1,500	

Adresa: Rruga “Ismail Zyma” Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al, info@uniel.edu.al

Kodi llog	Grup shpenzimi	Grant	Të ardhura	Totali
6022004	Posta dhe sherbimi korrier	200	0	200
6022007	Sherbimet bankare	100	0	100
6022008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	59,614	0	59,614
6022009	Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	4,800	0	4,800
6022010	Sherbime te printimit dhe publikimit	1,200	1,600	2,800
6022099	Sherbime te tjera	5,060	120	5,180
602.3	Shpenzime transporti	7,200	240	7,440
6023100	Karburant dhe vaj	6,600	0	6,600
6023200	Pjese kembimi, goma dhe bateri	240	120	360
6023300	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	360	0	360
6023900	Shpenzime te tjera transporti		120	120
602.4	Shpenzime udhetimi	15,000	0	15,000
6024100	Udhetim i brendshem	10,000	0	10,000
6024200	Udhetim jashte shtetit	5,000	0	5,000
602.5	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	32,800	240	33,040
6025300	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore	20,000	0	20,000
6025400	Shpenz. per miremb. e rrugeve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike, elektrike, telefonike, ngrohje etj	5,500	0	5,500
6025500	Shpenzime per mirembajtjen e aparateve, paisjeve teknike dhe veglave te punes	2,500	120	2,620
6025600	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	1,200	0	1,200
6025700	Shpenzime per mirembajtjen e rezervës shtetore		0	0
6025800	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te zyrave	3,600	120	3,720
602.6	Shpenzime per qeramarrje	4,200	480	4,680
6026100	Shpenzime per qeramarrje ambjentesh	4,200	0	4,200
6026900	Shpenzime te tjera qeraje	0	480	480
602.9	Shpenzime te tjera operative	34,874	15,724	50,598
6029001	Shpenzime per pritje e percjellje		1,200	1,200
6029004	Shpenzime per sigurimin e ndertesave dhe te tjera kosto sigurimi te ngjashme	5,000	0	5,000
6029006	Shpenzime kompesimi per anetaret e Parlamentit dhe zyrtare te tjera te zgjedhur	9,960	0	9,960
6029007	Shpenzime per pjesmarrje ne konferenca	360	0	360
6029008	Shpenzime per tatime & taksa te paguara nga institucioni	360	0	360
6029099	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime operative	19,194	14,524	33,718
	Totali	210,025	19,364	229,389

- **Kancelari.** Blerja e kancelarive është shpenzim i vazhdueshëm, pasi ato janë materiale konsumi. Ndër kancelaritë janë tonera e cartridge për printera e fotokopje, që kanë çmim të konsiderueshëm për njësi. Për vitin 2023 është parashikuar vlera 7,400 mijë lekë për kancelari. Blerja e tyre kryhet e përqëndruar për organizimin ekonomik me financë në Rektorat, që ka ky universitet, sipas kërkesave të fakulteteve për këto materiale. Për vitin 2022, si rezultat i zgjatjes së afateve të procedurave të prokurimit, kontrata me subjektin fitues është lidhur me datë 24.11.2022 për vlerën 1,570 mijë lekë dhe nuk është realizuar brenda këtij viti. Kjo kontratë është obliguar në sistemin SIFQ në Degën e Thesarit për tu realizuar në vitin 2023. Subjekti kontraktues ka paraqitur probleme në zbatimin e kësaj kontrate, duke paraqitur probleme në cilësinë e furnizimit me tonera për printera e fotokopje. Në këto kushte është parashikuar fondi për kancelari për të kryer procedurat e tenderimit në tremujorin e dytë të vitit 2023.
- **Shpenzimet për mbulimin e sinjalit të internetit në godinat e UE-së.** Referuar marrëveshjes ndëruniversitare me MAS-in dhe RASH-in, sinjali i internetit prej katër vjet është ofruar nga ky i fundit me pretendimin për lidhjen me rrjetin paneuropian për Kërkimin dhe Arsimin GËANT. Për ofrimin e këtij shërbimi RASH-i ka kërkuar pagesa kundrejt numrit faktik të studntëve të matrikulluar, ndërkohë që nuk ka dhënë informacion se sa studentë dhe punonjës të universitetit kanë lidhje faktike me projektin për Kërkimin dhe Arsimin GËANT. Meqenëse RASH në vitin 2021 e ndërpreu sinjalin Universiteti, parashikoi fonde për prokurimin e shërbimit të internetit me kompani që ofrojnë këtë



shërbim në të gjitha godinat me fibra optike dhe për rrjedhojë ky sinjal ofrohet nga kontraktori Albtelekom (Sot One Albania), sipas procedurës së prokurimit, kontratë e cila vijon deri në gusht 2023. Për vitin 2023 është parashikuar me të njëjtën procedurë prokurimi.

- **Shpenzimet për ekspeditat me studentët dhe praktikave mësimore në terren.** Referuar VKM-s përkatëse, institucioni mbulon vetëm shpenzimet për transportin dhe fjetjen, duke përjashtuar kështu dhënien e dietës, si për studentët, ashtu dhe për punonjësit akademikë e ndihmës që shoqërojnë studentët. Përcaktimi i këtij fondi është bërë në përputhje me parashikimet në planet mësimore të miratuara në Senatit Akademik, duke marrë në konsideratë kërkesat e departamenteve për kryerjen e ekspeditës së studentëve dhe praktikave mësimore në terren. Planifikimi i shpenzimeve për ekspeditat me studentët dhe praktikave mësimore në terren është në ulje për vitin 2023 nga parashikimi në PBA 2023-2025. Kjo për faktin e uljes së numrit të studentëve në këto programe studimi që zhvillohet ky proces mësimor. Kryesisht peshën kryesore për ekspeditat me studentët dhe praktikave mësimore në terren e ka programi i studimit “Bachelor në edukim fizik e sporte”, në zbatim të planit mësimor të skive, notit e sporteve malore.
- **Shpenzimet për shërbimin e ruajtjes e sigurisë.** Shërbimin e ruajtjes e sigurisë Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” e ka të shtrirë në të gjithë territorin e qytetit të Elbasanit, edhe në periferi të tij (Njësia Administrative Bradashesh), sikurse është cituar në paragrafin e përgjithshëm për mjediset universitare. Aktualisht ka në administrim 12 godina: Korpusi kryesor, Rektorati, Biblioteka, Shtëpia e pritjes, tre godina në FSHMT dhe truell 1,000 m² për ndërtim, FSHH (ish materniteti), Laboratori kërkimor FSHN (metalurgji) dhe Krasta me një sipërfaqe 21 ha. Ky shërbim është kryer me 17 vendroje nga të cilat 10 vëndroje me shërbim 24 orë, ndërsa 7 vëndroje janë me shërbim 8 orë, ndërkohë që janë vendosur 7 sisteme alarmi pa pagesë, në objekte të rëndësishme (magazinë, bibliotekë, laboratore etje.). Për këtë shërbim punojnë mesatarisht 62 punonjës shërbimi. Universiteti e ka të kontraktuar këtë shërbim me subjektin “UEVI-2015” shpk, e cila ka fituar procedurën në bazë të dokumentacionit të ofertës me marrëveshje kuadër dhe kontrata e dytë njëvjeçare përfundon me 20.04.2023. Sipas rekomandimeve të KLSH për reduktimin e këtij shërbimi e kryesisht për priudhën e pandemisë Covid19, nga specialistët e sektorit të shërbimeve e prokurimeve u rishikua grafiku i tij. Skema e mbulimit me vendroje dhe punonjës shërbimi për procedurën e vitit 2023-2024 është propozuar të kryhet me 13 vendroje nga të cilat 9 vëndroje me shërbim 24 orë, ndërsa 4 vëndroje janë me shërbim 8 orë, ndërkohë që do të vendosen 6 sisteme alarmi, në objekte të rëndësishme (magazinë, bibliotekë, laboratore etje.). Për këtë shërbim do të punojnë mesatarisht 52 punonjës shërbimi. Përllogaritja e vlerës së këtij shërbimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore për këtë qëllim, të cilët përcaktojnë pagën bazë mujore sa 150% e pagës minimale për kontribut në shkallë vendi. Nga 1 prill 2023 paga minimale për kontribut shkon në vlerën 40,000 lekë në muaj nga vlera 34,000 lekë në muaj, që është aktualisht. Me këto ndryshime preventivi për “Shpenzimet për shërbimin e ruajtjes e sigurisë” paraqitet;

Nr.	Zërat e shpenzimeve	VKM aktual	VKM ndryshim
A. Shpenzime për 9 vendroje me 4,98 punonjës/muaj/vendroje turni i I, II, III			
1	Shpenzime për pagë bazë	51,000.00	60,000.00
2	Shtesë mbi pagë për turnin II	1,073.88	1,263.37
3	Shtesë mbi pagë për turnin III	7,159.17	8,422.47
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%	9,891.92	11,637.53
	Kostoja në muaj për një punonjës Shuma	69,124.97	81,323.37

Adresa: Rruga “Ismail Zyta” Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al, info@uniel.edu.al



Nr.	Zërat e shpenzimeve	VKM aktual	VKM ndryshim
	Çmimi neto pa tvsh për 9 objekte (4.98*9)= 44.82 roje/muaj	3,098,181.16	3,644,913.44
B. Shpenzime për 4 vendroje x 1.66 punonjës/muaj/vendroje turni I-rë			
1	Shpenzime për pagë bazë	51,000	60,000
2	Sigurime shoqerore dhe shendetsore 16.7%	8,517	10,020
	Kostoja në muaj për një punonjës Shuma	59,517	70,020
	Çmimi neto pa tvsh për 4 objekte (4* 1,66)= 6.64 ne muaj	395,193	464,933
C. Shpenzime për 6 objektet me sistem alarmi (Turni II+ Turni III)			
	Kostoja në muaj për një sistem alarmi (Turni i II dhe Turni i III,- 16.00-08.00 e hënë - e premte dhe 24 orë e shtune, dielë e ditët e festave)	5,000	5,000
	Çmimi neto pa tvsh për 6 objekte x 5,000 = 35,000 në muaj	30,000	30,000
	Çmimi pa tvsh në muaj	3,523,374	4,139,846
	Çmimi pa tvsh (A+B+C) për 12 muaj	42,280,488	49,678,155
	TVSH	8,456,098	9,935,631
	Çmimi Neto me tvsh (A+B+C) për 12 muaj	50,736,586	59,613,786

- **Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore e mjedise të jashtme e kaldaja për ngrohje me vlerën 25,500 mijë lekë.** Më lart kemi përshkruar infrastrukturën ndërtimore të godinave dhe mjediseve të jashtme të Universitetit, e cila për nga shtrirja dhe sipërfaqja ndërtimore, kërkon shërbime mirëmbajtje. Në këto godina ka mbi 12 vjet që nuk janë kryer investime kapitale, përveç amortizimit vjetor të tyre. Ky proces në vite është realizuar pjesor për mungesë të fondeve për këtë qëllim, si p.sh. lysterja me bojë apo gëlqere e mjediseve të brendshme apo të fasadave. Disa mjedise janë të lyera që nga koha e ndërtimit apo rikonstruksionit, kryesisht fasadat e godinave nga viti 2008 deri në vitin 2011. Gjithashtu mirëmbajtje kërkojnë izolimi i tarracave, tubacionet e shkarkimit të ujrave të bardha, rrjetet elektrike e hidraulike, rrjetet e ngrohjes me kaldaja, mjediset e jashtme rrugë, trotuare, rrjeti i ndriçimit të jashtëm etje. Për vitin 2021 ishin parashikuar 14,000 mijë lekë për “mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore e mjedise të jashtme e kaldaja për ngrohje” procedura e prokurimit nuk përfundoi deri me 31.12.2021, pasi u anulua nga KPP. Ky proces vijoi për vitin 2022 me lidhjen e kontratës nr. 1464/14, datë 14.09.2022 me subjektin “INA” shpk, Tiranë e cila nuk e ka përfunduar mirëmbajtjen për procese shërbimi të vijuar në vite. Me evidentimin e problematikave për këto mjedise është parashikuar fondi në vlerën 25,500 mijë lekë.
- **Shpenzime për mirëmbajtjen e paisjeve të zyrave, auditorëve, aparaturave, paisjeve teknike, veglave të punës, me vlerën 6,340 mijë lekë.** Pajisjet e zyrave, auditorëve, aparaturat, pajisjet teknike, veglat e punës etje. Gjatë punës së tyre pësojnë defekte, konsum fizik dhe kanë nevojë për riparimin e tyre, për një vijimësi normale të procesit të punës. Ky shpenzim është i nevojshëm çdo vit deri në plotësimin e afateve të amortizimit e daljes jashtë funksioni të tyre. Për vitin 2023 janë parashikuar 6,340 mijë lekë nga e cila vlera 3,720 mijë lekë për mirëmbajtjen e pajisjeve të auditorëve e zyrave dhe 2,620 mijë lekë për mirëmbajtjen e aparaturave, pajisjeve teknike, veglave të punës.
- **Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit me vlerën 1,200 mijë lekë.** Universiteti ka në përdorim 3 mjete transporti nga të cilat 2 mjete të reja me vit prodhimi 2017, ndërsa një mjet i përdorur me vit prodhimi 1997. Këto mjete kanë nevojë për shërbime periodike, si dhe mirëmbajtje të konsumit të pjesve të amortizuara. Për shpenzime të mirëmbajtjes së mjeteve të transportit është parashikuar fondi me vlerën 1,200 mijë lekë
- **Shpenzime për blerje karburant për ngrohje.** Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” përbëhet nga 5 fakultete me njësitë bazë (departamente e qendra), Rektorati,



Biblioteka qendrore dhe Laboratori FSHN Metalurgji. Aktiviteti akademik dhe administrativ kryhet në 10 Godina, të cilat 8 prej tyre janë me sistem ngrohje, ku janë të vendosura 6 kaldaja. Sistemi i ngrohjes është me kaldaja të cilat punojnë me karburant (Gazoil). Gjithashtu nëpër godina janë të vendosur 5 gjeneratorë për prodhim energjie, në raste mungese energjie elektrike, të cilët punojnë me lëndë djegëse naftë (Gazoil). Universiteti ka tre mjete transporti në përdorim të stafit akademik e administrativ, të cilat punojnë me lëndë djegëse gazoil. Gjithashtu disponohen edhe pajisje pune në dispozicion të sektorit të shërbimeve, të cilat punojnë me lëndë djegëse. Furnizimi me lëndë djegëse (Gazoil) për kaldajat, kryhet nga subjektet furnizuese me bote rast pas rasti, pasi pranë secilit objekt (kaldaje) janë vendosur depozita të nëndheshme me kapacite të ndryshme nga 500 litra deri në 5000 litra, ndërkohë që mjetet e transportit furnizohen me karta elektronike të emetuar nga subjekti furnizues. Sipas përlogaritjeve, nevojat për karburant janë për 68,166 litra, ndërkohë që fondi në dispozicion është 6,600 mijë lekë.

➤ **Transferta të jashtme – Artikulli 605.**

Ky grup shpenzimi përfshin planifikimin e shpenzimeve lidhur me transferta në Valutë që rrjedhin nga zbatimimi i një marrëveshjeje apo kontrate ndërmjet Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” me universitete apo institucione të huaja që kanë për objekt shkëmbimin e eksperiencave në fushën e mësimdhënies apo kërkimit shkencor. Për vitin 2023 kemi parashikuar 900 mijë lekë nga të ardhurat e institucionit, nisur nga eksperiencia e viteve të mëparshme.

➤ **Transferta tek individë – Artikulli 606.**

Ky grup shpenzimi përfshin planifikimin e shpenzimeve lidhur me transferta tek studentë për pagesat e kryera gabimisht prej tyre, si dhe rimbursimin e pagesës së tarifës së shkollimit nëse studenti përfiton nga lehtësimet nga VKM përkatëse për mbështetjen studentore, përjashtim nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit për studentë me rezultate dhe ata me kritere të tjera lehtësuese. Gjithashtu në këtë artikull përfshihet edhe shpërblimi i një page nëse punonjësi del në pension, shpërblimi në raste fatkeqësie ose shpërblime për komisione të posaçme. Fondi i përlogaritur për këtë qëllim është 18,750 mijë lekë, i cili do të përballohet nga të ardhurat e institucionit.

➤ **Bursat financiare të studentëve dhe mbështetje financiare nga fondi ekselencës – Artikulli 606.**

Në këtë artikull përfshihen bursat financiare të studentëve (transferta tek individët) për Ciklin e parë të studimeve, si dhe mbështetje financiare nga fondi ekselencës për studentë të shkëlqyer dhe studentë që ndjekin studimet në fusha dhe programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar, i ndarë në;

- **Bursat financiare të studentëve (transferta tek individët) për Ciklin e parë të studimeve.** Fondi është akorduar në Grantin për bursat e studentëve në fillim të vitit dhe diferenca e trashëguar nga viti 2022, gjithsej vlera **148,131 mijë lekë**. Në PBA-në e viteve 2023-2025, për vitin 2022, ky fond është parashikuar për 1,600 studentë me fond 144,400 mijë lekë. Deri në datën 28.02.2023 janë paraqitur gjithsej 1,516 raste në ciklin e parë të studimit për program të parë studimi nga të cilat; kanë me kërkesa në portokoll gjithsej 1,406 raste me kritere të tjera dhe janë sjellë nga njësitë kryesore (Fakultetet) dhe QSHA 110 raste me rezultate. Kërkesat e studentëve që përfitojnë bursë financiare e përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit me kritere të tjera dhe me rezultate, janë përpunuar nga komisioni dhe janë hartuar listat përkatëse për vijimin e procedurave të mëtejshme. Deri me datë 14.02.2023 në Bordin e Administrimit janë dërguar 1,416 raste, i cili ka marrë vendim përfitim burse financiare 1,242 studentë, përjashtim nga tarifa e shkollimit 1,374



studentë. Nga kërkesat e paraqitura dhe në pritje për konfirmim nga institucionet përkatëse në zbatim të VKM nr. 903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, janë në pritje për miratim 35 raste.

Efektet e VKM-ve - Për studentë që përfitojnë bursë financiare për vitin akademik 2022-2023
000/lekë

Nr.	DEGA	I parë		I dytë		I tretë		Total	
		Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera	Nr st	Vlera
a.1	Bursa financiare me rezultate -Profes. 2-vjeç	0	0	2	180	0	0	2	180
a.2	Bursa financiare me rezultate -Bach	35	3,150	26	2,340	32	2,880	93	8,370
a.3	Bursa financiare me rezultate -DIND	4	360	7	630	4	360	15	1,350
I	Bursa financiare me rezultate	39	3,510	35	3,150	36	3,240	110	9,900
b.1	Bursa financiare me kriterë tjera - Profes. 2-vjeç	95	8,550	106	9,540	0	0	201	18,090
b.2	Bursa financiare me kriterë tjera -Bach	296	26,640	330	29,700	266	23,940	892	80,280
b.3	Bursa financiare me kriterë tjera -DIND	4	360	20	1,800	15	1,350	39	3,510
II	Bursa financiare me kriterë tjera	395	35,550	456	41,040	281	25,290	1,132	101,880
	Bursa financiare me VBA	434	39,060	491	44,190	317	28,530	1,242	111,780
c.1	Në pritje për miratim VBA-Profes. 2-vjeç	3	270	5	450	0	0	8	720
c.2	Në pritje për miratim VBA-Bach	12	1,080	9	810	4	360	25	2,250
c.3	Në pritje për miratim VBA-DIND	0	0	1	90	1	90	2	180
III	Bursa financiare në pritje për miratim BA	15	1,350	15	1,350	5	450	35	3,150
	Total Bursa Financiare UE	449	40,410	506	45,540	322	28,980	1,277	114,930

BA është shprehur me vendimet nr 2, datë 29.01.2023 dhe nr 5, datë 14.02.2023, i cilët janë ekzekutuar menjëherë nga Drejtoria ekonomike duke i dërgur bursat në llogarinë e studentëve.

Sipas përcaktimeve në VKM-n për bursat financiare, studenti në momentin e plotësimit të kriterëve të këtij vendim, paraqet kërkesën për bursë financiare në universitet dhe pas konfirmimit nga institucioni që ka lëshuar dokumentin, studenti e përfiton bursën muajin pasardhës nga paraqitja e kërkesës.

- **Mbështetje financiare nga fondi ekselencës për studentë të shkëlqyer dhe studentë që ndjekin studimet në fusha dhe programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar.** AKFAL ka dërguar pranë Universitetit 2 marrëveshje për përfitimin e mbështetjes financiare, në zbatim të VKM-s nr. 386, datë 01.06.2022 “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe udhëzimit të MAS nr. 30, datë 04.11.2022 për këtë qëllim. Ka lidhur marrëveshje për përfitimin financiar me datë 13.02.2023 AKFAL, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe studentja Endi Iftimi Hida në programin e studimit “Bachelor në ekonomi turizëm” në FE. Ka lidhur marrëveshje për përfitimin financiar me datë 13.02.2023 AKFAL, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe studentja dhe studentja Paola Petrit Balliu në programin e studimit “Bachelor në biologji-kimi” në



FSHN. Fondi për bursat e mbështetjes financiare është akorduar në Degën e Thesarit me vlerë 680 mijë lekë.

➤ **Shpenzime për investime** - artikulli 230/231

Investimet kryhen nga Universiteti duke i përballuar me fonde, të cilat financohen nga:

- Grant konkurrues janë planifikuar dy objekte investimi për vitin 2023 me vlerë totale 999,867 mijë lekë.
- Të ardhurat e vetë institucionit për investime sipas objekteve me vlerë totale janë **1,778,975** mijë lekë, financimi për vitin 2023 në vlerën 438,872 lekë.
- Disbursim për projektet e huaja me vlerën 35,192 mijë lekë, i cili në sistemin SIFQ ngarkohet në Investime (231), ndërkohë që planifikimi dhe pagesa kryhet; për shpenzime korente vlera 33,741 mijë lekë, investime vlera 1,450 mijë lekë. TVSH- ja për këto investime me vlerë 412 mijë lekë rimburohet nga Buxheti i Shtetit.

Investime viti 2023						000/ lekë
Nr.	Emërtimi i projektit	Total	Të ardhura		Buxheti	Disb. të Huaja
			Plani 2023	Vlera totale		
I	Studime e projekttime, patenta, liçenca, softje kompjuterike	4,500	4,500	4,500	0	0
II	Ndërtime të reja	2,660,501	327,444	1,661,046	999,455	0
III	Rikonstruksione	72,929	66,429	72,929	0	0
IV	Paisje inventar ekonomik	19,000	19,000	19,000	0	0
V	Paisje profesionale	15,000	15,000	15,000	0	0
VI	Mjete transporti	6,500	6,500	6,500	0	0
VII	Projekte të huaja	35,604	0	0	412	35,191
	Shuma	2,807,534	438,872	1,778,975	999,867	35,191

- Grant konkurrues janë fondet që përballohen nga buxheti i shtetit, të cilat deri në këto momente nuk janë akorduar fonde (çelje në degën e Thesarit). Nga Universiteti janë dërguar për konkurrim;
 - Objekti "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane - ish materniteti", dërguar për konkurim në vitin 2018 me vlerë **699,455** mijë lekë me kontribut nga universiteti 210,000 mijë lekë nga të ardhurat, për të cilin është ngurtësuar rreth 70% të vlerës në degën e Thesarit, në momentin e dërgimit për konkurim, ndërsa nga Buxheti i Shtetit vlera 489,455 mijë lekë. Ky objekt nuk u financua gjatë viteve 2018-2022. Parashikohet të ridërgohet kërkesa për konkurim, duke vendosur nga universiteti vlerën 30,000 mijë lekë për vitin 2023 dhe vlerën 180,000 mijë lekë në vitet në vijim.

Investime Bashkëfinancim (Buxhet të ardhura) viti 2023					000 lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Total	2023	2024-2025	
a)	Financim nga të ardhurat	210,000	30,000	180,000	
b)	Financim nga Buxheti Shtetit	489,455	0	489,455	
1	"Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane " - ish materniteti	699,455	30,000	669,455	
a)	Financim nga të ardhurat	415,833	267,718	148,115	
b)	Financim nga Buxheti Shtetit	510,000	0	510,000	
2	"Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT"	925,833	267,718	658,115	
	Totali	1,625,288	297,718	1,327,570	

- Objekti " Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike – FSHMT", dërguar për konkurim në vitin 2022 me vlerë **925,833** mijë lekë me kontribut nga universiteti 415,833 mijë lekë nga të ardhurat, ndërsa nga Buxheti i Shtetit vlera



510,000 mijë lekë. Ky objekt ka fituar financimin dhe me Email-in e MAS, datë 06.01.2023 tabela “Detajimi i investimeve për vitin 2023-2025” objekti “Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike – FSHMT” për vlerën 510,000 mijë lekë në vitet 2024-2025.

- **Investimeve nga të ardhurat e vetë institucionit** me fond 581,461 mijë lekë. Këto investime ndahen në:

- **Studime e projektme, patenta, liçenca, soffte kompjuterike – artikulli 230**

- **Studime e projektme.** Në këtë grup përfshihen shpenzimet për studime e projektme, të cilat për vitin 2023 është parashikuar për financim 1 objekt me vlerë 2500 mijë lekë **Projekt + preventiv për projekte të ndryshme**
- **Në patenta, liçenca, soffte kompjuterike** është planifikuar vlera 2,000 mijë lekë soft për pajisjet laboratorike ose inventar ekonomik (pajisje kompjuterike).

- **Investimet - Artikulli 231: Ndërtime, rikonstruksion objekte ndërtimore, pajisje.** Në këtë grup përfshihen shpenzimet për investime për: ndërtime e rikonstruksione objektesh, blerje pajisje për auditorë e zyra, blerje pajisje laboratorike për laboratorët mësimorë e shkencor fondit i librit për bibliotekën etje., me fond të përgjithshëm në vlerën 1,772,458 mijë lekë dhe plan i vitit 2023 në vlerën 438,872 mijë lekë. Projektet e investimeve për tu financuar paraqiten në tabelën “Investime viti 2023 - të ardhurat e institucionit” dhe zënë rreth 73.8 % të të ardhurave të institucionit.

- **"Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane".** Godina e ish-maternitetit në vitin 2005, i ka kaluar me VKM Ministrisë së Arsimit e Shkencës për Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, ndërkohë që ky objekt me marrëveshje ju la në përdorim QS “Xhafer Kongoli”, deri në ndërtimin e objektit të Kirurgjisë pranë kësaj qëndre. Ky objekt nuk mund të adaptohej për mjedise mesimdhënie, pasi rikonstruksioni i saj kërkon më shumë investime. Universiteti aktualisht ka dy fakultete në mjediset e Korpusit kryesor: FSHH dhe FSHN. Në mjediset e Korpusit kryesor në vite janë kryer investime për laboratorët e FSHN-s. Në këto kushte, pa kosto për universitetin është , që të zhvendoset FSHH. Objekti "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane" - ish materniteti " me vlerën totale 699,455 mijë lekë, është parashikuar në planin strategjik të zhvillimit të Arsimit të lartë në periudhën 2006-2009. studim- projektimi i së cilës është hartuar në vitin 2006. Universiteti nuk mund ta përballojë këtë investim dhe në vijimësi është kërkuar Bashkëfinancim me Buxhetin e Shtetit, sikurse është theksuar më lart, në planifikimin e buxhetit, si në PBA-të e viteve edhe në buxhetin e këtij viti. Sipas procedurave ndërtimore për ndërtimet e reja apo rikonstruksionet në ndërtim, është e domosdoshme:
- **"Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT "**. Universitetit me VKM nr. 66 datë 03.02.2021 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga MSHMS te MASR për Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, të pasurisë së paluajtshme nr. 7/19/2, në zonën kadastrale 8,525”, i ka kaluar një sipërfaqe truall 1,000 m² . Projekt ideja e ndërtimit të godinës së FSHMT është godinë tre katëshe mbi tokë me salla videokonference, salla leksioni e seminari me parkim të nëndheshëm mbi 1,200 m² duke shfrytëzuar dhe sheshin para godinës “A” të FSHMT-së. Ndërtimi i mjedisëve mësimorë në këtë fakultet është i domosdoshëm, pasi në këtë fakultet studiojnë 3,297 studentë; në kohë normale 2,341 studentë dhe të padiplomuar 956 studentë. Për këtë objekt është kryer studim projektimi në vitin 2022. Për këtë objekt është parashikuar fondi me



vlerë 925,833 mijë lekë. Mbikqyerje - "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT" me vlerë paraprake 8,533 mijë lekë. Kolaudim - "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT" me vlerë paraprake 1,024 mijë lekë. Oponencë teknike - "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT" me vlerë 200 mijë lekë. Leje ndërtimi - "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT" me vlerë 27,000 mijë lekë. Universiteti ka kryer aplikimin për leje ndërtimi.

- **Rikonstruksion - "Aspirim kondicionim Godina A , Korpusi Kryesor - fasada xhamit"**. Në godinën e Korpusit kryesor janë krijuar mjedise për personelin akademik dhe administratën e dy fakulteteve: FSHN e FSHH. Në kohën kur është kryer investimi, sikurse është theksuar në vite të mëparshme, nuk është investuar për kushtet shëndetësore të tyre. Për këto mjedise është hartuar studim projektim dhe është parashikuar për vitin 2023 Rikonstruksion - "Aspirim kondicionim Godina A , Korpusi Kryesor - fasada xhamit" , me preventiv rikonstruksioni me vlerë 12,866 mijë lekë. Sipas procedurave ndërtimore për ndërtimet e rikonstruksionet në ndërtim, është parashikuar për vitin 2023 e domosdoshme Mbikqyerje - "Aspirim kondicionim Godina A, Korpusi Kryesor- fasada xhamit" me vlerë 258 mijë lekë. Kolaudim - "Aspirim kondicionim Godina A, Korpusi Kryesor- fasada xhamit" me vlerë 31 mijë lekë.
- **Rikonstruksion - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C**. Në godinën e Korpusit kryesor janë krijuar mjedise laboratorike për personelin akademik dhe administratën e dy fakulteteve: FSHN e FSHH. Në këto mjedise laboratorike për të krijuar kushte sa më të favorshme shëndetësore në realizimin procesit mësimor në laborator, kërkojnë investim në aspirim kondicionim. Për këto mjedise është hartuar studim projektim Rikonstruksion - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C", dhe parashikohet për vitin 2023, me preventiv rikonstruksioni me vlerë 21,648 mijë lekë. Sipas procedurave ndërtimore për ndërtimet e rikonstruksionet në ndërtim, është parashikuar për vitin 2023 e domosdoshme: Mbikqyerje - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C" me vlerë 393 mijë lekë. Kolaudim - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C" me vlerë 47 mijë lekë.
- **"Rikonstruksion salla e konferencave 111 - FSHE"** me vlerë 19,793 mijë lekë. Objekti i godinës së Fakultetit të shkencave të edukimit është rikonstruktuar në vitin 2008-2009, ndërkohë që del e nevojshme rikonstruksion në sallat e konferencave. Projekt-ideja për këtë objekt, është bazuar në kapacitetet akademike që ka FSHE (Fakulteti i shkencave të edukimit), pasi ky fakultet mbulon masterat e mësuesisë. Sipas procedurave ndërtimore për ndërtimet e rikonstruksionet në ndërtim, është parashikuar për vitin 2023 e domosdoshme Mbikqyerje - " Rikonstruksion salla e konferencave 111 - FSHE " me vlerë 351 mijë lekë. Kolaudim - " Rikonstruksion salla e konferencave 111 - FSHE " me vlerë 42 mijë lekë.
- **"Sistem WiFi në godinat e UE-së"** me vlerë 17,500 mijë lekë. Me këtë objekt investimi do të mundësohet lidhja e të gjithë godinave të Universitetit me WiFi
- **Pajisje inventar ekonomik me vlerë 19,000 mijë lekë** . "Pajisje kompjuterike, fotokopje, printera e videoprojektor"; Në UE është investuar në blerjen e pajisjeve



kompjuterike e fotokopje, si për laboratorët e informatikës në fakultete edhe për personelin akademik e administrativ. Universiteti në IT ka mjedise informatike në të gjitha njësitë kryesore kryesisht në FSHN që mbulon procesin e mësimdhënies së IT për të gjitha programet studimit në Universitet. Këto pajisje, sikurse e kemi thesuar më lart, veç amortizimit fizik dalin jashtë funksioni për amortizimin moral të tyre, si rezultat i zhvillimit të kësaj teknologjie me ritme të shpejta. Sipas të dhënave të pasqyrave financiare rezulton se pajisjet kompjuterike e fotokopje me përdorim mbi 5 vite janë amortizuar mbi 90% të vlerës së mbetur, ndërsa pajisjet e hyra në përdorim 5 vitet e fundit janë amortizuar në masën 63%. Krahas përqindjes së lartë të konsumit të pajisje kompjuterike e fotokopje në funksionimin e tyre normal një problem i ndërlikuar është llojshmëria e markave të tyre, pasi secili prej tyre ka të instaluar softë të kompanive prodhuese, të cilat për arsye komercialiteti kanë konflikte në funksionimin normal, aq më tepër në lidhjen e tyre në rrjet Domain apo në Intranet. Kohët e fundit meqë teknologjia softëer-ike ka zhvillime galopante pajisjet dalëse (printera e fotokopje) paraqesin vështirësi në funksionimin e tyre. Këto pajisje dalin shpesh herë nga rrjeti (funksioni), pasi draiverat (Driver) janë të markave të ndryshme në lidhje me markën e kompjuterit me të cilin është i lidhur, ose vetë kompanitë i nxjerrin jashtë funksionit për arsye të hedhjes në treg të një versioni të fundit. Ky proces ka risk ekonomik, jo vetëm në mbarëvajtjen e punës por edhe në mbetjen stok të toner-ave apo drum-eve, pasi pajisjet dalin jashtë pune. Në vijimësi në hartimin e PBA-ve të çdo viti janë planifikuar fonde nga 10,000 mijë lekë deri në 20,000 mijë lekë, por në asnjë vit buxhetor nuk është realizuar në nivelin e planifikimit të tyre. Investimet në “Pajisje kompjuterike, fotokopje, printera e videoprojektor”, për një mbarëvajtje normale të punës duhet të planifikohen fonde për rinovimin e tyre nga 8,000 mijë lekë për vitin 2023. “Pajisje e orendi për auditore laboratore e zyra”; Në UE është investuar në blerjen e “Pajisje e orendi për auditore laboratore e zyra”, si për laboratorët, auditorët e mjediset e personelit akademik e administrativ. Në vazhdimësi është investuar në pajisje e orendi, ndërkohë zgjerimet e vazhdueshme në këto mjedise dhe amortizimi i tyre kërkon investime për të realizuar funksionim normal të punës në laboratorë. Për vitin 2023 është parashikuar për Pajisje e orendi për auditore laboratore e zyra vlera 6,880 mijë lekë. Ky investim do të përmirësojë kushtet e mësimin për studentët dhe kushtet e punës për stafin akademik. *Fond libri për bibliotekën*; Biblioteka e UE-së është pasuruar në vazhdimësi me fond libri, krahas dhurimit nga institucione e personalitete brenda vëndit apo të huaja, është investuar me fonde nga të ardhurat. Për vitin 2023 është parashikuar për Fond libri për bibliotekën fondi 4,000 mijë lekë, në funksion të aktivitetit normal të saj. Sektori i shërbimit në UE është pajisur me pajisje pune të nevojshme për mirëmbajtjen e mjedisëve të jashtme të gjelbëruara në qendër e fakultete apo mjedise të brendshme: Motokorrëse, motosekë, trapan, vidator, matrapik etje. Për vitin 2023 është parashikuar për pajisje pune me vlerë 120 mijë lekë.

- **Pajisje profesionale me vlerë 15,000 mijë lekë**. Në UE është investuar në blerjen e pajisjeve laboratorike në fakultete, si në rinovimin e laboratorëve ekzistues, por edhe në krijimin e laboratorëve të rinj, sikurse e kemi theksuar me zhvillimin e programeve të reja të studimit në këtë Universitet. Për vitin 2023 është parashikuar për Pajisje laboratorike vlera 15,000 mijë lekë, për: Laboratori i mamisë në FSHMT, Laboratorë të ndryshëm sipas kërkesave të departamenteve.



- **Mjete transporti me vlerë 6,500 mijë lekë**. UE ka në përdorim tre mjete transporti në dispozicion të personelit akademik dhe administratës, njëra prej të cilave është e vitit të regjistrimit 1997, i cili kërkon riparime kapitale dhe me gjendjen fizike të tij nuk mund të kryhen lëvizje të stafit apo studentëve. UE ka investuar në blerjen e dy mjeteve të transportit, për të cilat në 4 vite ka shpenzuar vetëm për shërbime periodike. Gjatë ushtrimit të aktivitetit ka lëvizje të shumta të stafit akademik, si brenda vëndit ashtu edhe jashtë vëndit kryesisht në vëndet e Ballkanit. Krahas lëvizjes së stafit, në kuadër të marrëveshjeve dhe programeve të bashkëpunimit kërkohet edhe lëvizja e brendshme e stafit të huaj, si në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, por edhe në proceset e konferencave apo projekteve kërkimore. Sipas planeve mësimore të miratuara në Senatit akademik, një pjesë e programeve të mësuësishë zhvillojnë praktika në terren. Në këto kushte është e domosdoshme blerja e një mjet transporti me kapacitet 8+1 e papërdorur.

Tabela 27.4 Investime viti 2023 - të ardhurat e institucionit 000/ lekë

Nr	Emërtimi i projektit	Total	Plani	Prokurimi
I	Studime e projekte, patenta, liçenca, soffte kompjuterike	4,500	4,500	4,500
a	Studime e projekte	2,500	2,500	2,500
1	Projekt + preventiv - projekte të ndryshme	2,500	2,500	2,500
b	Patenta, liçenca, soffte kompjuterike	2,000	2,000	2,000
1	Soffte kompjuterike laborator	2,000	2,000	2,000
II	Ndërtime të reja	1,661,046	327,444	1,661,046
1	"Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave humane " - ish materniteti	699,455	30,000	699,455
2	"Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT"	925,833	267,718	925,833
3	Mbikqyerje - "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT"	8,533	2,500	8,533
4	Oponencë teknike - "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT"	200	200	200
5	Leje ndërtimi - "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT"	27,000	27,000	27,000
6	Taksa (Rilevim topografik)- "Ndërtim i godinës së Fakultetit të shkencave mjeksore teknike - FSHMT"	25	25	25
III	Rikonstruksione	72,929	72,929	72,929
1	Rikonstruksion - "Rikonstruksio aspirim kondicionim Godina A, Korpusi Kryesor - fasada xhamit"	12,866	12,866	12,866
2	Mbikqyerje - "Rikonstruksion aspirim kondicionim Godina A, Korpusi Kryesor- fasada xhamit"	258	258	258
3	Kolaudim - "Rikonstruksio aspirim kondicionim Godina A, Korpusi Kryesor- fasada xhamit"	31	31	31
4	Rikonstruksion - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C"	21,648	15,148	21,648
5	Mbikqyerje - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C"	393	393	393
6	Kolaudim - "Aspirim kondicionim laboratorëve Korpusi kryesor Godina C"	47	47	47
7	"Rikonstruksion salla e konferencave 111 - FSHE"	19,793	19,793	19,793
8	Mbikqyerje - "Rikonstruksion salla e konferencave 111 - FSHE"	351	351	351
9	Kolaudim - "Rikonstruksion salla e konferencave 111 - FSHE"	42	42	42
10	"Sistem ËiFi në godinat e UE-së"	17,500	17,500	17,500
IV	Pajisje inventar ekonomik	19,000	19,000	19,000
1	Pajisje kompjuterike/Sofëare e fotokopje	8,000	8,000	8,000
2	Pajisje e orëndi për auditore laboratore e zyra	6,880	6,880	6,880
3	Fond libri biblioteka	4,000	4,000	4,000
4	Pajisje pune	120	120	120

Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al, info@uniel.edu.al



Nr	Emërtimi i projektit	Total	Plani	Prokurimi
V	Pajisje profesionale	15,000	15,000	15,000
1	Pajisje laboratorike	15,000	15,000	15,000
VI	Mjete transporti	6,500	6,500	6,500
1	Mjete tjera transp	6,500	6,500	6,500
	Shuma	1,778,975	438,872	1,778,975

➤ **Fondi për kërkimin shkencor.**

Në Buxhetin e Univesitetit për kërkimin shkencor për vitin 2023 janë parashikuar projekte kërkimore gjithsej në vlerën 79,929 mijë lekë nga:

- Granti konkurrues për kërkim shkencor nga Buxheti i Shtetit vlera 28,753 mijë lekë nga të cilat vlera 5,026 mijë lekë është e trashëguar dhe e çelur për përdorim në Degën e Thesarit. Janë gjithsej 8 projekte kërkimore që financohen nga AKKSHI me vlerë 11,054 mijë lekë. Nga këto projekte 3 prej tyre kanë filluar në vitin 2021 dhe ka mbetur vlera 1,232 mijë lekë, ndërsa 5 projekte janë financuar në vitin 2022 me vlerë 6,067 mijë lekë, ndërsa për vitin 2023 është vlera 3,793 mijë lekë

Tabela 27.5 **Projekte kërkimore të financuara nga AKKSHI** 000/lekë

Nr	Emertimi i projektit te investimit	Vlera e plote	Realizuar deri 2022	Buxheti 2023
1	"Mësimdhënia në periudhë pandemie: Zhvillimi i Kapaciteteve Studentore (cikli i dytë i studimeve, Master) gjatë një procesi arsimor të alternuar fizik e në distancë" - Dr. Lenida Lekli	1,264	994	183
2	"Hulumtimi i ndryshimit të modeleve të punësimit (fuqisë punëtore) gjatë dhe pas pandemisë së COVID 19 në qarkun Elbasan" - Prof.As. Imelda Sejdini	1,933	1,176	616
3	"Ndikimi i COVID-19 në organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor; implementimi i një modeli epidemiologjik-matematikor" - Dr. Elona Gaxhja	1,790	1,148	434
4	"Studimi i emigrimit tek të rinjtë e qarkut Elbasanit: arsyet,kostot dhe mënyrat e zbutjes" - Prof. As. Dr. Alketa Vangjeli	988	256	731
5	"Vlerësimi i praktikave profesionale përmes kornizës së kompetencave për studentët kandidatë për mësues" - Prof. As. Dr. Elisabeta Osmanaj	1,334	260	1,074
6	"Marrëdhënia midis tipologjive të dhunës në familje dhe variablave psiko-socialë." - Dr. Roksana Poçi	921	272	649
7	"Evidentimi e vlerësimi floristik i Parkut Kombëtar "Shebenik" si dhe ngritja e kapaciteteve bashkëpunuese me Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Elbasan.." - Prof. as. Dr. Nikoleta Kallajxhiu (Dr. Ermelinda Gjeta)	1,296	549	746
8	"Mbi studimin dhe vlerësimin e shëndetit mendor në periudhën post COVID, në grupmoshat 15-24 vjeç." - Dr. Gjergji Koja	1,529	937	592
	Shuma	11,055	5,592	5025

Për vitin 2023 do të dërgohen për aplikim në AKKSHI 15 projekte kërkimore me vlerë 27,515 mijë lekë

Tabela 27.6 **Projekte kërkimore për Aplikim në AKKSHI** 000/lekë

Nr	Emertimi i projektit te investimit	AKKSHI
1	"Studim i faktorëve që ndikojnë në performancën akademike të studentëve në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", bazuar në mënyrën e zakoneve apo të sjelljes së të mësuarit." - Dr. Liljana Ramasaço	2,523
2	"Rritja e ndergjegjesimit te edukimit financiar tek të rinjte në Qarkun e Elbasanit " - Dr Eliona Gremi	1,952
3	"Shqyrtimi i faktorëve që ndikojnë në stilin e jetesës të studentëve në Universitetin e Elbasanit: Promovimi i një stili jetese të shëndetëshme" - Ph.D. Armela Kapaj	2,870
4	"Ura ndërlidhëse në fushat e Shkencave të Natyrës dhe Mjekësore Teknike për Hulumtim e Zhvillim Strukturor të "Zinxhirit për Kërkim Integral në Shkencë dhe Jetë - ZKISHJ" - Dr. Dhurata Valera	2,624
5	"Korniza Evropiane e sipërmarrjes në qendër të përgatitjes të studentëve si sipërmarrës dhe fuqi punëtore e së ardhmes " - Dr. Teuta Hazizi	1,076
Nr	Emertimi i projektit te investimit	AKKSHI



6	"Hulumtim mbi faktorët që ndikojnë në pjesëmarrjen e ulët në votime të të rinjve në Bashkinë Elbasan" - Dr. Elda Gjergji	623
7	"Ulja e varfërisë nëpërmjet fuqizimit të grave në zonat rurale të Elbasanit, duke diversifikuar burimet e të ardhurave të tyre" - Dr. Kladiola Gjini	1,075
8	"Hulumtime mbi funksionin dhe karakteristikat gjuhësore të diskursit të nxënësve të Arsimit të Mesëm të Lartë (probleme në përdorimin e tipave kumtuesorë të fjalive)" - Dr. Resul Telhaj	1,729
9	"Praktikat prindërore dhe cilësia e të nxënësve në arsimin bazë pas periudhës Covid-19" - Dr Ardian Tana	945
10	"Letërsia për fëmijë e të rinj dhe identiteti kombëtarLetërsia për fëmijë e të rinj dhe identiteti kombëtar" - Dr. Mirela Shella	1,329
11	"Dokumentimi, regjistrimi dhe ruajtja e pasurisë gjuhësore dhe etnokulturore të pakicës rome në rajonin e Elbasanit. Dokumentimi, regjistrimi dhe ruajtja e pasurisë gjuhësore dhe etnokulturore të pakicës rome në rajonin e Elbasanit" - Prof.as.dr. Teuta Toska	1,720
12	"Impakti i bullizimit mbi zhvillimin psikosocial të moshave shkollore.Ngritja e kapaciteteve njerëzore." - Prof. As. Dr. Lindita Durmishi	2,145
13	"Shëndeti mendor te prindërit e fëmijëve me Çrregullim të Spektrit të Autizmit" - Dr. Jonida Mustafaraj	2,717
14	"Studimi dhe hartëzimi i industrië së sportit në Shqipëri" - Prof. as. dr. Edmond Biçoku	1,547
15	"Hartëzimi i zonave të ndotura (hot spots) në qytetin e Elbasanit dhe identifikimi i metodave të rikuperimit të gjelbërt (green recovery)" - Prof. as. Dr. Elvira Fetahu	2,640

- o Fondet për kërkimin shkencor nga të ardhurat e institucionit janë parashikuar në 74,903 mijë lekë. Ky fond kërkimor ndahet;

- Projektet kërkimore nga të ardhurat e institucionit me bashkëfinancim. Janë 17 projekte me bashkëfinancim, të cilët janë financuar nga AKKSHI ose do të dërgohen për aplikim në AKKSHI me vlerë 1,956 mijë lekë.

Nr	Emertimi i projektit te investimit	Ardhurat 2023
1	"Mësimdhënia në periudhë pandemie: Zhvillimi i Kapaciteteve Studentore (cikli i dytë i studimeve, Master) gjatë një procesi arsimor të alternuar fizik e në distancë" - Dr. Lenida Lekli	50
2	"Hulumtimi i ndryshimit të modeleve të punësimit (fuqisë punëtore) gjatë dhe pas pandemisë së COVID 19 në qarkun Elbasan" - Prof.As. Imelda Sejđini	58
3	"Vlerësimi i praktikave profesionale përmes kornizës së kompetencave për studentët kandidatë për mësues" - Prof. As. Dr. Elisabeta Osmanaj	190
